



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master në
“Shkenca Komunikimi” me profile a) “Marrëdhënie Publike Politike”;
b) “Menaxhim Marketingu”
ofruar nga
Universiteti Europian i Tiranës**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

**Dr. Blerina Gjerazi
Dr. Ardita Reçi**

Tetor /2025

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile:
“Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu” ofruar nga Universiteti
Europian i Tiranës

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Europian i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi”, me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 74, datë 21.01.2009.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMAS.Nr. 8244/2 Prot., datë 12.09.2018.
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASR Nr. 67, datë 03.02.2021 (profili “Marrëdhënie Publike Politike”); UMASR Nr. 69, datë 03.02.2021 (profili “Menaxhim Marketingu”);
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdhër Nr. 23, datë 11.05.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	V.a 2022-2023:10 PAE/1 PAK V.a 2023-2024 10 PAE/4 PAK V.a 2024-2025: 10 PAE/3 PAK
18	Numri i studentëve:	Numri i studentëve për profilin:”Marrëdhënie Publike Politike” V.a 2022-2023:15 studentë; V.a 2023-2024:12 studentë; V.a 2024-2025:13 studentë

		Numri i studentëve për profilin: "Menaxhim Marketingu" V.a 2022-2023: 12 studentë; V.a 2023-2024: 11 studentë; V.a 2024-2025: 9 studentë
19	Komente / të tjera:	



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit, pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, në Universitetin Europian të Tiranës. Ky program është akredituar për herë të parë me Urdhër Nr. 23, datë 11.05.2018 dhe realizohet me një ngarkesë akademike prej 120 kreditesh ECTS, të strukturuar për t’u përmbushur përgjatë dy viteve akademike.

Programi synon të përgatisë profesionistë të kualifikuar në fushën e komunikimit strategjik, me fokus të veçantë në dy profile të specializuara:

- Marrëdhënie Publike Politike
- Menaxhim Marketingu

Nëpërmjet një qasjeje të integruar teorike dhe praktike, programi zhvillon kompetenca të avancuara në planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e strategjive të komunikimit në kontekste institucionale, politike dhe tregtare. Ai përgatit studentët për të kuptuar dhe menaxhuar proceset komplekse të komunikimit ndërmjet organizatave dhe publikut të tyre, duke theksuar rëndësinë e analizës së opinionit publik, ndërtimit të imazhit, komunikimit me media dhe përdorimit të platformave digjitale.

Mësimdhënia zhvillohet në një mjedis akademik bashkëkohor, të pajisur me infrastrukturë moderne dhe mjete didaktike interaktive që lehtësojnë përvetësimin e dijeve dhe zhvillimin e aftësive praktike. Stafi akademik, i përbërë nga pedagogë me përvojë të gjerë profesionale dhe kërkimore, garanton cilësi të lartë të mësimdhënies dhe mbështetje të vazhdueshme për studentët gjatë gjithë procesit të studimit.

Të diplomuarit e këtij programi janë të përgatitur për të ndjekur karrierë në institucione publike, agjenci marketingu, strukturat e marrëdhënies me publikun, organizata politike, si dhe për të vijuar studimet në ciklin e tretë ose në fusha të afërta të komunikimit, marrëdhënies ndërkombëtare apo administrimit publik.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu” është realizuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe metodologjik të përcaktuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), me qëllim vlerësimin gjithëpërfshirës të cilësisë akademike dhe përputhshmërisë së programit me standardet kombëtare dhe evropiane të arsimit të lartë. Ky proces synoi të analizojë funksionimin dhe efektivitetin e programit në disa dimensione kryesore, përfshirë: përmbajtjen dhe strukturën akademike, rezultatet e të nxëniet, metodat e mësimdhënies, angazhimin institucional për përmirësimin e cilësisë, si dhe relevancën e programit në raport me kërkesat e tregut të punës në fushën e komunikimit, marrëdhënieve publike dhe marketingut.

Mbështetur në VKM nr.109/2017, ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu”. Bazuar në Urdhrin Nr.124, datë 10.10.2023 të ASCAL, “Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programit të studimit, aplikuar nga Universiteti i Tiranës, grupi i vlerësimit të jashtëm për këtë program studimi përbëhet nga Dr. Blerina Gjerazi dhe Dr. Ardita Reçi.

Gjatë procedurës, GVJ është asistuar nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, Alma Arapi.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) shqyrtoi në mënyrë të detajuar dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni, përfshirë raportin e vetëvlerësimit, programet mësimore, informacionin mbi kualifikimet e stafit akademik, të dhëna statistikore mbi përparimin e studentëve dhe shkallën e punësimit të tyre, si dhe informacion mbi kapacitetet infrastrukturore dhe burimet e disponueshme për zhvillimin e programit.

Në datat 21 dhe 22 maj 2025, GVJ realizoi një vizitë në ambientet e institucionit për të zhvilluar takime me drejtues institucionalë, staf pedagogjik, studentë, si dhe përfaqësues të strukturave administrative e mbështetëse. Këto takime patën për qëllim të verifikonin në praktikë përputhjen midis dokumentacionit të paraqitur dhe realitetit institucional, në përputhje edhe me të dhënat e regjistruara në sistemin AMS të ASCAL. Takimet u karakterizuan nga një atmosferë bashkëpunuese dhe një qasje e hapur e stafit dhe studentëve ndaj pyetjeve dhe reflektimit kritik mbi funksionimin e programit. Ky vlerësim u konsiderua nga aktorët institucionalë si një mundësi e rëndësishme për reflektim strategjik dhe për forcimin e mëtejshëm të mekanizmave të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Gjatë gjithë procesit, GVJ është udhëhequr nga disa parime themelore të garantimit të cilësisë:

- Objektiviteti, përmes vlerësimeve të mbështetura në të dhëna të besueshme dhe të verifikuara;

- Dialogu konstruktiv, i ndërtuar mbi partneritetin dhe transparencën me institucionin pritës;
- Konfidencialiteti, në menaxhimin e informacionit gjatë procesit të vlerësimit;
- Analiza gjithëpërfshirëse, që merr në konsideratë të gjitha aspektet akademike, administrative dhe institucionale të programit;
- Përputhshmëria me standardet kombëtare dhe evropiane, si garanci për cilësi dhe konkurrueshmëri në sistemin e arsimit të lartë.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit janë:

Bordi i Akreditimit ka vendosur dhënien e akreditimit për një periudhë 6-vjeçare, pa lënë asnjë rekomandim.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

IAL ka miratuar me Vendim Senati Nr. 5, datë 20.09.2022 ndryshimet deri në 20% në programin e studimit (ku krahas disa ndryshimeve në kurrikulën e programit, është riemërtuar profili “Marrëdhënie Publike Politike” në “Marrëdhënie Publike”), ndryshime të cilat nuk janë miratuar nga MAS me shkresën Nr. 2484/1 Prot., datë 21.08.2023, pasi sikurse cituar në shkresë riemërtimi i profileve të disa programeve apo ofrimi i programeve pa profile, që në aktin e hapjes përcaktohen me profile, sjell ndryshim të emërimit të programit të studimit, ndryshimi i emërimit bëhet kur ka ndryshime në masën mbi 20% të përmbajtjes së tyre dhe për këto raste ndiqen procedura të tjera përmes platformës e-albania.

Me shkresën nr. 65/2 prot., datë 23.08.2023, UET ka kërkuar në MAS një saktësim të qëndrimit të MAS lidhur me mos miratimin e ndryshimeve të miratuara me VS nr. 5, datë 20.09.2022 për këtë program studimi, ku ka ritheksuar se ndryshimet janë profilizuese nën 20%. MAS, me shkresën nr. 2484/3 prot., datë 07.11.2023 është shprehur se mban të njëjtin qëndrim të shprehur më herët në shkresën nr. 2484/1 prot., datë 21.08.2023, në të cilën evidentohet se riemërtimi i profileve apo ofrimi i programit pa profile përbëjnë ndryshim të emërimit dhe thekson se sipas udhezimit nr. 1, datë 14.01.2020 i ndryshuar, ndryshimet nën 20% nuk duhet të ndryshojnë emërtesën e programit të studimit, por vetem ndryshime profilizuese.

IAL ka konfirmuar se programi ka dy profile aktive: “Marrëdhënie Publike Politike” dhe “Menaxhim Marketingu”.

IAL-së i është kërkuar nga ASCAL të konfirmojë nëse kanë aplikuar/do aplikohet për riorganizimin e këtij programi mbi 20% sikurse cituar në përgjigjet e MAS (ku përfshihet ndryshimi i emërimit të një prej profileve aktive konfirmuar nga IAL) dhe akreditimi i këtij programi do të vijojë vetëm për profilet “Marrëdhënie Publike Politike” dhe “Menaxhim Marketingu”, konfirmuar nga IAL si profilet aktive, për ata studentë që janë aktualisht në sistem, deri në diplomimin e tyre.

IAL ka konfirmuar se nuk ka aplikuar për riorganizim. Duke qenë se ndryshimet nuk u miratuan nga MAS, programi ka vijuar të ofrohet me emërtim e mëparshëm zyrtar të miratuar nga MAS, sikurse janë vendosur dhe në aplikimin për akreditim.

Universiteti Europian i Tiranës, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 07.10.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 14 / 27 Prot, datë 07.10.2025. Universiteti Europian i Tiranës , njofton në ASCAL më datë 10.10.2025, me anë të shkresës me Nr.271/7 Prot, datë 09.10.2025 “Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi”, me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu” i ofruar nga Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit në Universitetin European të Tiranës është konceptuar dhe zhvilluar në përputhje me parimet themelore të arsimit të lartë dhe në reflektim të nevojave aktuale të shoqërisë dhe tregut të punës për profesionistë të aftë në fushën e komunikimit publik. Programi ofrohet me dy drejtime të specializuara:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ Menaxhim Marketingu, i cili përqendrohet në ndërtimin e strategjive komunikative në mjediset tregtare dhe institucionale;▪ Marrëdhënie Publike Politike, që synon të zhvillojë kompetenca në komunikimin institucional, politik dhe mediatic në kontekste demokratike. <p>Ky program synon të formojë profesionistë që veprojnë si ndërmjetësues të besueshëm ndërmjet institucioneve, organizatave dhe publikut, duke nxitur qasje transparente, etikë komunikimi dhe ndërtim të diskursit të përgjegjshëm publik. Në thelb të filozofisë së tij qëndron zhvillimi i mendimit kritik, aftësive strategjike dhe përdorimi i mjeteve bashkëkohore të komunikimit për të ndikuar pozitivisht në hapësirën publike dhe kulturore. Në përputhje me standardet ligjore dhe akademike të arsimit të lartë në Shqipëri, si dhe në harmoni me praktikat më të mira evropiane, programi ofron një formim të qëndrueshëm teorik dhe praktik, duke kontribuar në mënyrë të prekshme në forcimin e komunikimit institucional, zhvillimin e mediave demokratike, si dhe promovimin e marrëdhënieve etike dhe të qëndrueshme ndërmjet aktorëve publikë dhe qytetarëve.</p> <p>Ky program përfaqëson një investim domethënës në përgatitjen e specialistëve të komunikimit që janë në gjendje të operojnë në një kontekst gjithnjë e më të ndërlikuar digjital dhe ndërdisiplinor, duke ruajtur angazhimin ndaj vlerave të</p>



	<p>shërbimit publik, përfaqësimit të interesit të qytetarëve dhe forcimit të proceseve demokratike.</p> <p><i>E.2 Statuti (shqip)_struktura organizative aktuale</i> <i>E.3 Plani Strategjik UET 2021-2025</i> <i>E.5 Rregullore UET</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu” është konceptuar dhe zbatuar në përputhje të plotë me misionin institucional dhe objektivat strategjike të Universitetit European të Tiranës, si një institucion i arsimit të lartë që promovon ekspertizë akademike, kërkim shkencor cilësor dhe formim profesional të qëndrueshëm në përputhje me nevojat e tregut dhe të shoqërisë bashkëkohore. Në thelb të misionit të institucionit qëndron zhvillimi i dijeve, nxitja e mendimit kritik dhe përgatitja e kuadrove të kualifikuar që kontribuojnë në mënyrë aktive në jetën publike dhe institucionale të vendit. Programi pasqyron këtë mision duke ofruar një formim të thelluar teorik dhe praktik në fushën e komunikimit strategjik, me dy drejtimet e tij të specialitetit. Struktura, përmbajtja dhe rezultatet e të nxënimit të programit janë në harmoni me profilin akademik të universitetit dhe me drejtimet prioritare të tij kërkimore, të përcaktuara qartë në Planin Strategjik 2021-2025, si dhe Strategjinë e Kërkimit Shkencor 2021-2025.</p> <p>Programi kontribuon gjithashtu në përmbushjen e objektivit të Universitetit European të Tiranës për të forcuar kapacitetet demokratike dhe kultivimin e një kulture të komunikimit etik, transparent dhe të përgjegjshëm. Nëpërmjet ndërthurjes së dijeve akademike, praktikave bashkëkohore dhe qasjeve ndërdisiplinore, programi përgatit profesionistë të aftë të analizojnë, hartojnë dhe menaxhojnë strategji komunikimi, duke iu përgjigjur sfidave të një mjedisi të ndërlikuar mediatic dhe institucional.</p> <p><i>E.2 Statuti (shqip)_struktura organizative aktuale</i> <i>E.3 Plani Strategjik UET 2021-2025</i> <i>E. 3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025</i> <i>E.5 Rregullore UET</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu” është konceptuar dhe ofruar në përputhje të plotë me Strategjinë e Zhvillimit, Statutin dhe</p>

<p>zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Rregulloren e Universitetit European të Tiranës, duke reflektuar qartë orientimet institucionale për zhvillimin e qëndrueshëm të arsimit të lartë, rritjen e cilësisë akademike dhe forcimin e kapaciteteve kërkimore. Në përmbajtjen, drejtimin dhe strukturën e tij, programi pasqyron prioritetet strategjike të institucionit, të cilat përfshijnë: promovimin e inovacionit në mësimdhënie, integrimin e komponentit kërkimor në formimin akademik, si dhe lidhjen e ngushtë të arsimit me zhvillimet e tregut të punës dhe të shoqërisë. Programi kontribuon në realizimin e vizionit institucional për formimin e specialistëve të kualifikuar në fushën e komunikimit, të aftë për të operuar në një mjedis të ndërlkuar profesional dhe për të ndikuar në mënyrë konstruktive në hapësirën publike.</p> <p>Fushat dhe drejtimet akademike të programit, të përqendruara në Menaxhim Marketingu dhe Marrëdhënie Publike dhe Politike, janë tërësisht në përputhje me profilin institucional dhe me zhvillimin e disiplinave të shkencave sociale dhe humane që universiteti mbështet në mënyrë strategjike.</p> <p>Hartimi dhe miratimi i programit është kryer në zbatim të procedurave të përcaktuara nga kuadri ligjor dhe aktet e brendshme të institucionit, përmes një procesi të strukturuar që ka përfshirë Departamentin e Shkencave Humane dhe Komunikimit, strukturat përkatëse të Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, si dhe Senatin Akademik. Ky proces garanton standarde të larta cilësie dhe koherencë me strategjinë afatmesme dhe afatgjatë të universitetit.</p> <p><i>E.2 Statuti (shqip)_struktura organizative aktuale</i> <i>E.3 Plani Strategjik UET 2021-2025</i> <i>E. 3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025</i> <i>E.5 Rregullore UET</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prijet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu” është i konceptuar dhe zhvilluar në përputhje të plotë me Strategjinë e Kërkimit Shkencor të Universitetit European të Tiranës (2021–2025), duke integruar kërkimin si një komponent thelbësor në formimin akademik dhe profesional të studentëve. Në përputhje me vizionin institucional, UET synon të shndërrohet në një qendër ekselence dhe ekspertize në fushat e studimeve shoqërore dhe humane, duke kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin kombëtar dhe rajonal. Ky orientim mbështet</p>




	<p>zhvillimin e programeve të ciklit të dytë që përforcojnë kapacitetet kërkimore të studentëve dhe stafit akademik, veçanërisht në temat që lidhen me komunikimin publik, marrëdhëniet institucionale, ndikimin e mediave, zhvillimet teknologjike në fushën e informacionit dhe etikën e komunikimit.</p> <p>Në linjë me misionin kërkimor të UET, programi synon të mbështesë transformimin e universitetit nga një institucion i fokusuar në mësimdhënie në një institucion elitare kërkimor, ku produkti kërkimor është i lidhur me kërkesat e tregut, zhvillimet socio-politike dhe nevojat për ekspertizë në fushën e komunikimit. Kjo pasqyrohet në përfshirjen e komponentëve kërkimorë në planin mësimor, në nxitjen e projekteve studimore, si dhe në përdorimin e rezultateve të kërkimit për të përmirësuar procesin e mësimdhënies dhe për të fuqizuar rolin aktiv të studentëve në hulumtim.</p> <p>Gjithashtu, duke qenë pjesë e “European Charter for Researchers” dhe “Code of Conduct for the Recruitment of Researchers”, UET demonstroi angazhimin për cilësinë, etikën dhe ndërkombëtarizimin në fushën e kërkimit shkencor. Këta komponentë krijojnë një mjedis të favorshëm për zhvillimin e programeve master që përmbushin standarde evropiane dhe ndërkombëtare, në përputhje me Kriterin 4.</p> <p><i>E.3 Plani Strategjik UET 2021-2025</i></p>							
Konkluzione	<p><i>Universiteti European i Tiranës e zhvillon dhe e ofron këtë program studimi në përputhje të plotë me misionin institucional, objektivat strategjike dhe vlerat themelore që ai përfaqëson në hapësirën kombëtare të arsimit të lartë. Harmonizimi i programit me strategjinë e zhvillimit të institucionit, me Statutin dhe kuadrin përkatës rregullator krijon një bazë të qëndrueshme për formimin akademik dhe profesional të studentëve.</i></p>							
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	<table border="1"> <tr> <td>Përmbushet pjesërisht</td> </tr> </table>	Përmbushet pjesërisht	<table border="1"> <tr> <td>Përmbushet kryesisht</td> </tr> </table>	Përmbushet kryesisht	<table border="1"> <tr> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet								
Përmbushet pjesërisht								
Përmbushet kryesisht								
Përmbushet plotësisht								
				X				

<p>Standardi I.2 Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
Kriteret	Vlerësimi

<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvijën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit, si njësi bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit “Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu”, disponon kapacitete të plota akademike dhe organizative për garantimin e cilësisë në procesin e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Staf i akademik i angazhuar në program përbëhet nga pedagogë me përgatitje të lartë shkencore dhe përvijë të gjerë profesionale në fushën e komunikimit dhe disiplinave të ndërlidhura. Përbërja e tij përfshin profesorë me tituj akademikë (Prof. Dr.), pedagogë me gradë shkencore “Doktor Shkencash”, si dhe staf në proces doktorature, të angazhuar në mënyrë aktive në kërkime shkencore dhe projekte akademike, në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo strukturë mundëson mbulimin e një spektri të gjerë tematikash dhe metodologjish bashkëkohore, në përputhje me objektivat dhe përmbajtjen e programit.</p> <p>Kjo bazë akademike garanton ndërthurjen e njohurive teorike me zhvillimin e aftësive analitike dhe praktike, duke mundësuar përgatitjen e studentëve në nivel të avancuar dhe me kompetenca të aplikueshme në tregun e punës dhe në mjedis akademike. Për më tepër, programi mbështetet nga infrastrukturë didaktike moderne, që përfshin mjete audio-vizive, platforma të mësimdhënies interaktive, qasje të gjerë në burime bibliografike digjitale, si dhe ambiente të përshtatshme për studim dhe zhvillim kërkimor. Burimet dhe kapacitetet infrastrukturore krijojnë një mjedis të favorshëm për të nxitur cilësinë akademike, angazhimin studentor dhe zhvillimin profesional në përputhje me standardet bashkëkohore të arsimit të lartë.</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e</p>	<p><i>E. 4 Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit</i> <i>E. 7 Rregullore_MSH_Shkenca Komunikimi</i> <i>E. 20 CV e stafit - MSH Shkenca Komunikimi</i> <i>E. 42 Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta</i> <i>E. 42.1 Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu” zhvillohet në linjë të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, si njësi kryesore për ofrimin e</p>

<p>kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>tij. Përmbajtja dhe orientimi i programit reflektojnë qartë prioritetet akademike të fakultetit, i cili fokusohet në zhvillimin e disiplinave të shkencave humane dhe sociale, ku komunikimi zë një vend qendror.</p> <p>Programi i përket fushës së njohurive në shkencat e komunikimit dhe është ndërtuar në përputhje me klasifikimin kombëtar të programeve të studimit dhe direktivat evropiane për arsimin e lartë. Kjo e bën të përshtatshëm si nga pikëpamja institucionale, ashtu edhe nga aspekti i zhvillimit të mëtejshëm akademik dhe kërkimor në këtë fushë.</p> <p>Përputhja tematike dhe metodologjike ndërmjet strukturave të fakultetit dhe objektivave të programit tregon qartë se ky është një program i konceptuar dhe i zhvilluar në përkim të plotë me profilin shkencor të njësisë që e ofron.</p> <p><i>E. 7 Rregullore_MSH_Shkenca Komunikimi</i> <i>E.3 Plani Strategjik UET 2021-2025</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu” është projektuar dhe ofruar në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë, përkatësisht Departamentit të Shkencave Humane dhe Komunikimit, që funksionon në përbërje të Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale në Universitetin European të Tiranës.</p> <p>Programi zhvillohet në bazë të një kurrikulë të ndërtuar mbi disiplina thelbësore të fushës së komunikimit, të tilla si: Teoritë e Aplikuara të Komunikimit, Komunikim Masiv Bashkëkohor, Strategji Komunikimi për Mediat e Reja, Analizë Kritike e Ligjërimit, Komunikimi, Etika dhe Lidërshipi në Organizatë, etj., të cilat pasqyrojnë qartë profilin shkencor dhe pedagogjik të departamentit ofrues.</p> <p>Për më tepër, profilizimi i programit në dy drejtime, “Marrëdhënie Publike Politike” dhe “Menaxhim Marketing” ruan përputhjen tematike me drejtimet kërkimore dhe kompetencat ekzistuese brenda departamentit, duke përfshirë lëndë si Marrëdhënie Publike Politike, Diplomaci Publike, Marketing Ndërkombëtar, Menaxhim Eventesh, të cilat janë të mbuluara nga stafi akademik me përvojë dhe ekspertizë në fushat përkatëse. Struktura ndërdisiplinore e programit pasqyron natyrën integruese të komunikimit si fushë studimi, pa devijuar nga baza e tij shkencore, e cila mbetet brenda fushës së shkencave sociale dhe humane. Kjo strukturë lejon</p>

	<p>thelimin profesional të studentëve në fusha të aplikuara të komunikimit publik dhe të korporatave, pa dalë jashtë kompetencës akademike të njësisë bazë ofruese.</p> <p><i>E.2 Statuti (shqip)_struktura organizative aktuale</i> <i>E.3 Plani Strategjik UET 2021-2025</i> <i>E. 3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025</i> <i>E.5 Rregullore UET</i> <i>E. 4 Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit</i> <i>E. 7 Rregullore_MSH_Shkenca Komunikimi</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master shkencor” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Ky program zhvillohet plotësisht brenda fushës së ekspertizës akademike dhe kërkimore të njësisë përgjegjëse Departamentit të Shkencave Humane dhe Komunikimit dhe është në përputhje të plotë me profilin institucional të Universitetit European të Tiranës. Si e tillë, nuk është e nevojshme përfshirja e institucioneve të tjera partnere për garantimin e cilësisë së programit.</p> <p><i>E.2 Statuti (shqip)_struktura organizative aktuale</i> <i>E.3 Plani Strategjik UET 2021-2025</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Universiteti European i Tiranës ka një angazhim të vazhdueshëm për përgatitjen e studentëve në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe për mbështetjen e zhvillimit të tyre profesional edhe pas përfundimit të studimeve. Kjo bëhet e mundur përmes një sërë mekanizmash institucionale të krijuar enkas për këtë qëllim, si dhe përmes partneriteteve të qëndrueshme me sektorin privat, publik dhe organizatat jofitimprurëse.</p> <p>Një nga iniciativat më të rëndësishme në këtë drejtim është Programi 500+, një projekt strategjik pesëvjeçar i bashkëpunimit me 500 kompanitë më të mëdha në vend, i cili synon të forcojë lidhjen ndërmjet universitetit dhe tregut të punës. Ky program përfshin praktika profesionale, dizajn të përbashkët modulesh dhe mundësi trajnimi për studentët dhe të diplomuarit, duke reflektuar nevojat konkrete të sektorit të punësimit.</p> <p><i>E. 28.1 Projekte UET 2017-2024</i> <i>E. 12.5 Forumi 500+</i> <i>E. 34 Lista e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit</i> <i>Faqja zyrtare e UET. Punësim & Internship për studentë.</i> https://uet.edu.al/rreth-uet/</p>

Konkluzione	<i>Programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Komunikimi" me profile: "Marrëdhënie Publike Politike", "Menaxhim Marketingu" është plotësisht në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore përgjegjëse, Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, duke respektuar klasifikimin dhe kodifikimin e programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare dhe evropiane. Përmbajtja e programit reflekton qartësisht drejtimet strategjike të zhvillimit akademik dhe kërkues në fushën e shkencave të komunikimit, përfshirë marrëdhëniet publike, menaxhimin e komunikimit dhe qasjet ndërdisiplinore të komunikimit bashkëkohor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Institucioni garanton funksionimin e qëndrueshëm dhe cilësor të programit të studimit përmes një strukture të qartë organizative dhe ndarjeje funksionale të detyrave ndërmjet njësive akademike dhe administrative. Hartimi, zbatimi dhe monitorimi i programit zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet Departamentit të Shkencave Humane dhe Komunikimit, strukturave drejtuese të Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, si dhe njësive të mbështetjes institucionale, si Zyra e Sigurimit të Cilësisë, Zyra e Karrierës dhe Zyra e Projekteve.</p> <p>Roli i çdo strukture përcaktohet qartë në dokumentet institucionale, duke mundësuar ndarjen e përgjegjësisë dhe angazhimin aktiv të stafit akademik dhe administrativ në të gjitha fazat e ciklit të programit. Përmes analizave periodike, diskutimeve departamentale dhe mekanizmave të brendshëm të sigurimit të cilësisë, realizohet vlerësimi i vazhdueshëm i përmbajtjes, ecurisë së mësimdhënies, kërkesave të tregut dhe përmirësimeve të nevojshme.</p> <p><i>E. 7 Rregullore_MSH_Shkenca Komunikimi</i></p>

	<p><i>E. 20 CV e stafit - MSH Shkenca Komunikimi</i></p> <p><i>E.17 Studimi për Tregun e Punës</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, ,institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Në funksion të realizimit të objektivave të procesit mësimor dhe formues të studentëve, Universiteti European i Tiranës ka ndërtuar një rrjet të gjerë bashkëpunimi institucional brenda dhe jashtë vendit, duke përfshirë institucione të arsimit të lartë, organizata ndërkombëtare, partnerë nga sektori privat dhe aktorë të shoqërisë civile. UET ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me mbi 20 universitete partnere në kuadër të programeve Erasmus+, Jean Monnet, Tempus dhe projekteve të tjera ndërkombëtare, si: Bologna University (Itali), Minho University (Portugali), Hague University (Holandë), Malardalen University (Suedi), Catholic University of Valencia (Spanjë), Middle East Technical University (Turqi), etj. Këto bashkëpunime përfshijnë mobilitet studentësh dhe stafit akademik, shkëmbim përvojash pedagogjike, si dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta kërkimore dhe formuese.</p> <p>Në nivel kombëtar, UET bashkëpunon me universitete publike dhe jopublike si “Aleksandër Moisiu” në Durrës, “Fan Noli” në Korçë, “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan, Universiteti i Tiranës, Universiteti Bujqësor i Tiranës, “Luarasi”, “Marin Barleti” dhe “Polis”, në kuadër të projekteve të përbashkëta arsimore dhe kërkimore në fushën e zhvillimit të kapaciteteve institucionale dhe akademike.</p> <p>Për më tepër, përmes programeve si “500+”, UET ka ndërtuar partneritete afatgjata me kompani dhe institucione vendase, duke mundësuar përfshirjen aktive të aktorëve të tregut të punës në praktikën profesionale, mentorim, projekte zhvillimi dhe trajnim të studentëve dhe të diplomuarve.</p> <p>Këto marrëdhënie bashkëpunimi kontribuojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies, përmirësimin e përvojës akademike të studentëve, ndërkombëtarizimin e kurrikulave dhe përgatitjen e tyre për sfidat reale të tregut kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p> <p><i>E. 7 Rregullore MSH Shkenca Komunikimi</i></p> <p><i>E. 34 Lista e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit</i></p> <p><i>E. 28.1 Projekte UET 2017-2024</i></p> <p>https://uet.edu.al/inter-institutional-agreement/</p> <p>https://uet.edu.al/projects/</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit,</p>	<p>Universiteti European i Tiranës ka vendosur si prioritet strategjik lidhjen e ngushtë midis formimit akademik dhe</p>

<p>institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>praktikës profesionale, në funksion të përgatitjes së studentëve për tregun e punës. Për realizimin efektiv të programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi”, institucioni ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione publike e jopublike, agjenci mediatike, kompani të sektorit të komunikimit dhe marketingut, agjenci PR, organizata të shoqërisë civile dhe institute kërkimore që operojnë në fushat përkatëse të profilit të programit.</p> <p>Këto marrëveshje përfshijnë ofrimin e praktikave profesionale të mbikëqyrura, angazhimin e ekspertëve të fushës në mentorimin e studentëve, përfshirjen e tyre në projekte zhvillimore dhe nxitjen e kërkimit të aplikuar në kontekste reale pune. Praktika profesionale, e integruar në strukturën e programit me një numër të konsiderueshëm kreditesh, mbikëqyret nga stafi akademik në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësuesit e institucioneve pritëse, duke garantuar përmbushjen e objektivave formues dhe profesionalë. Gjithashtu, përmes rrjetit të partnerëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë, UET nxit mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik për qëllime kërkimore dhe zhvillimi profesional. Ky bashkëpunim i ndërsjellë siguron jo vetëm zbatimin e praktikave cilësore, por edhe ndërlidhjen e programit me nevojat konkrete të tregut dhe zhvillimet e fundit në fushën e komunikimit, marketingut dhe marrëdhënieve publike.</p> <p>Praktika profesionale është e integruar në kurrikulën e programit me 12 kredite ECTS dhe mbikëqyret nga stafi akademik në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësuesit e institucioneve pritëse, duke garantuar përmbushjen e objektivave formues dhe profesionalë. Përmes këtyre praktikave, studentët fitojnë përvojë të drejtpërdrejtë në mjediset profesionale, ndërkohë që përforcojnë njohuritë teorike me aftësi praktike në fushën e komunikimit.</p> <p><i>E. 7 Rregullore_MSH_Shkenca Komunikimi</i> <i>E. 28.1 Projekte UET 2017-2024</i> <i>E. 34 Lista e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e</p>	<p>Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit, si njësia përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” në Universitetin Europian të Tiranës, zhvillon në mënyrë periodike procese të sistematizuara të monitorimit dhe vlerësimit të bashkëpunimeve institucionale. Këto procese përfshijnë hartimin e raporteve analitike që</p>

bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	<p>evidentojnë përfitimet konkrete nga marrëveshjet e bashkëpunimit dhe ndikimin e tyre në realizimin dhe cilësinë e programit. Raportet përfshijnë analiza të hollësishme mbi efektivitetin e praktikave profesionale, mobilitetit akademik dhe studentor, bashkëpunimit në projekte kërkimore dhe aktivitete të tjera shkencore. Përmes këtij mekanizmi, departamenti siguron një vlerësim të vazhdueshëm të ndikimit të partneriteteve në arritjen e objektivave mësimorë dhe profesionalë, duke mundësuar përmirësime të bazuara në të dhëna empirike dhe rekomandime për optimizimin e bashkëpunimit institucional.</p> <p><i>E. 35 Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit - MSH</i></p> <p><i>E. 38 Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se institucioni i arsimit të lartë ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në ndërtimin dhe konsolidimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucione publike dhe private, organizata ndërkombëtare, si dhe aktorë kyç në fushën e komunikimit dhe shkencave humane. Këto bashkëpunime janë reflektuar në funksion të realizimit efektiv të programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Komunikimi" me profile , duke kontribuar në zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve, përfshirjen e tyre në projekte kërkimore me fokus aplikativ, si dhe në nxitjen e avancimit akademik dhe shkencor.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
---	----------------	-----------------------	----------------------	-----------------------------------

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi
-----------------	------------------



<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu” është strukturuar në përputhje të plotë me legjislacionin vendor në fuqi dhe me kërkesat e Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Struktura e programit përfshin komponentë të qartë dhe të balancuar akademikë, të ndarë në kategori të përcaktuara:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ A - Lëndë bazë me një total prej 12 kreditesh ECTS, që sigurojnë themelimin teorik dhe konceptual të fushës së komunikimit; ▪ B - Lëndë karakterizuese me peshë kryesore prej 60 kreditesh ECTS, të cilat mbulojnë në mënyrë të detajuar profilin akademik dhe kërkimor të programit; ▪ C - Lëndë ndërdisiplinore dhe integruese, me 18 kredite ECTS, që promovojnë lidhjen ndërmjet disiplinave të ndryshme dhe zhvillimin e një perspektive të gjerë; ▪ D - Lëndë plotësuese me 12 kredite ECTS, që pasurojnë kurrikulën me njohuri dhe aftësi të nevojshme për sfidat bashkëkohore; ▪ E - Detyrime përmbyllëse, me 18 kredite ECTS, që konsolidojnë njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë studimeve përmes punimit të diplomës. <p>Ndarja e krediteve reflekton një qasje të standardizuar në planifikimin akademik, duke siguruar përmbushjen e objektivave mësimore dhe njohjen ndërkombëtare të studimeve.</p> <p><i>E. 7 Rregullore_MSH_Shkenca Komunikimi</i> <i>E. 14 Kurrikula e programit</i> <i>E. 14.2 Plani mësimor - shqip</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri,</p>	<p>Masteri i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu”, prezanton një strukturë të qëndrueshme dhe të mirëbalancuar në përmbajtjen akademike, metodologjinë e mësimdhënies dhe objektivat e tij të qarta. Ky program është projektuar për të ofruar një thellim të njohurive teorike dhe aftësive kërkimore e praktike në fushën e komunikimit, duke u fokusuar në zhvillimin e kapaciteteve analitike dhe kritike të studentëve në kontekstin e sfidave bashkëkohore mediatike dhe komunikative.</p>

<p>aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Struktura e programit përfshin module kryesore që adresojnë aspekte të ndryshme të komunikimit, përfshirë teorinë e avancuara të komunikimit, strategjitë e menaxhimit të fushatave, komunikimin masiv bashkëkohor, marrëdhëniet publike politike dhe menaxhimin e marketingut, duke u mbështetur në një qasje ndërdisiplinore dhe integruese. Procesi mësimor realizohet me metoda bashkëkohore si seminare interaktive, punë projektuale, diskutime kritike, dhe praktikë profesionale, që mundësojnë një ndërthurje efektive midis teorisë dhe praktikës.</p> <p>Sikurse është përcaktuar nga vetë njësia bazë, qëllimi i programit është të zhvillojë njohuri të avancuara dhe aftësi të specializuara në fushën e komunikimit, duke përfshirë analizën kritike dhe aplikimin e teorive në praktikë. Programi përgatit studentët për role profesionale në fushat e Marrëdhënieve Publike Politike dhe Menaxhimit të Marketingut, duke u fokusuar në strategjitë e komunikimit institucional, menaxhimin e imazhit, ndërtimin e marrëdhënieve me publikun dhe zhvillimin e fushatave efektive të marketingut. Studentët fitojnë aftësi për të planifikuar, zbatuar dhe vlerësuar strategji komunikimi që i përgjigjen mjedisit mediatic dhe organizatave.</p> <p><i>E. 4. Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit</i> <i>E. 4.1 Objektivat e programit të studimit</i> <i>E. 7 Rregullore_MSH_Shkenca Komunikimi</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit ka përcaktuar qartë ngarkesën në kredite për komponentët praktikë dhe përmbyllës të tij, në përputhje me standardet e arsimit të lartë. Konkretisht, Praktika Profesionale është e planifikuar me 12 kredite ECTS, duke siguruar përvojë të drejtpërdrejtë dhe të strukturuar në mjedisin profesional relevant për fushën e komunikimit. Gjithashtu, detyrimet përmbyllëse, ku përfshihet punimi i diplomës, mbulojnë 18 kredite ECTS, duke garantuar një proces të thelluar hulumtimi dhe reflektimi akademik që konsolidon njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë studimeve.</p> <p>Struktura e ngarkesës kreditive për praktikën dhe tezën e diplomës është në përputhje me standardet e arsimit të lartë dhe VKM-në Nr. 879, datë 18.12.2019, i ndryshuar, duke siguruar një balancë të mirë mes përgatitjes teorike dhe asaj praktike.</p> <p><i>E. 7 Rregullore_MSH_Shkenca Komunikimi</i></p>

	<p><i>E. 14 Kurrikula e programit</i> <i>E. 14.2 Plani mësimor - shqip</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>NA</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>NA</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Programi i studimit master i shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu” është organizuar dhe zbatuar në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi të arsimit të lartë dhe udhëzimet specifike të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Ky program respekton në mënyrë rigorozë të gjitha kërkesat që lidhen me organizimin e ciklit të dytë të studimeve, procesin e pranimit të studentëve dhe financimin në institucionet e arsimit të lartë.</p> <p>Procesi i pranimit të studentëve realizohet në përputhje të plotë me Rregulloren e Studimit duke u bazuar në kritere dhe procedura të qarta të përcaktuara sipas kuadrit ligjor dhe</p>

	<p>standardeve akademike të institucionit, si dhe në Statutin e Universitetit European të Tiranës.</p> <p>Në dokumentacionin dhe evidencën e programit, trajtohen në mënyrë të detajuar të gjitha aspektet ligjore, akademike dhe administrative, duke garantuar që organizimi i studimeve të jetë i qëndrueshëm dhe në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Kjo qasje institucionalizon një ambient të favorshëm për zhvillimin akademik dhe profesional të studentëve, duke u ofruar atyre mundësi të barabarta për përvetësimin e njohurive dhe aftësive në fushën e komunikimit, në harmoni me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet globale.</p> <p><i>E. 4. Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit</i> <i>E. 4.1 Objektivat e programit të studimit</i> <i>E. 7 Rregullore_MSH_Shkenca Komunikimi</i></p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit master i shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu” në Universitetin European të Tiranës është hartuar dhe strukturuar në përputhje me praktikën më të mira akademike dhe standardet kombëtare, duke siguruar që përmbajtja e tij të jetë në përputhje të ngushtë me programet e tjera të ciklit të dytë në të njëjtën fushë studimi dhe me emërtim të ngjashëm. Një analizë krahasuese e kurrikulave dhe rezultateve të të nxënies tregon se programi garanton një përputhshmëri minimale prej 70% në nivelin akademik, përmbajtjen tematike dhe kompetencat e zhvilluara, duke ruajtur një ekuilibër mes harmonizimit me standardet rajonale dhe veçantive të profilit institucional. Kjo qasje siguron njohjen dhe vlerësimin e programit në kuadrin e arsimit të lartë, duke favorizuar lëvizshmërinë akademike dhe bashkëpunimin ndërinstitucional.</p> <p><i>E. 7 Rregullore_MSH_Shkenca Komunikimi</i> <i>E. 14 Kurrikula e programit</i></p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu”, është kodifikuar me numrin 72MS0399S, në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit Nr. 31, datë 15.11.2022 “Për procedurat e kodifikimit të programeve të studimit” dhe VKM Nr. 310, datë 11.05.2022, që rregullojnë klasifikimin dhe kodifikimin zyrtar të programeve të arsimit të lartë në Shqipëri. Ky kodifikim garanton</p>

<p>Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>standardizimin institucional dhe kombëtar të programit, duke mundësuar identifikimin e saktë të tij në sistemet e administrimit akademik, raportimit statistikor dhe njohjes ndërinstucionale, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar.</p> <p><i>E. 31 Udhëzim-Nr. 31, datë 15.11.2022 Procedurat e kodifikimit të programeve</i></p> <p><i>E. 31.1 VKM Nr.310, datë 11.05.2022_Kodifikimi i programeve</i></p> <p><i>E. 31.2 Shkresë MAS_Udhëzim_Për afatet e kodifikimit të programeve të studimit</i></p> <p><i>E. 31.3 Shkresë UET_propozimet për kodifikimin e programeve të studimit</i></p>
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Universiteti Europian i Tiranës mbështet dhe promovon zhvillimin e programeve të përbashkëta të studimit në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, si vendas ashtu edhe ndërkombëtarë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në kuadër të bashkëpunimeve, UET ka nënshkruar marrëveshje me mbi 20 universitete partnere të njohura, si pjesë e programeve Erasmus+, Jean Monnet, Tempus dhe projekteve të tjera ndërkombëtare. Këto institucione përfshijnë emra të njohur si Bologna University (Itali), Minho University (Portugali), Hague University (Holandë), Malardalen University (Suedi), Catholic University of Valencia (Spanjë), dhe Middle East Technical University (Turqi), ndër të tjera. Në nivel vendor, UET bashkëpunon ngushtë me universitete publike dhe jopublike, si Universiteti “Aleksandër Moisiu” në Durrës, Universiteti “Fan Noli” në Korçë, Universiteti “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan, Universiteti i Tiranës dhe të tjera, në kuadër të projekteve të përbashkëta akademike dhe kërkimore. Këto iniciativa i përgjigjen nevojave për ndërkombëtarizim të arsimit dhe rritje të cilësisë akademike, duke ofruar studentëve mundësi të zgjeruara për përgatitje profesionale dhe akademike në mjedise multidisiplinare dhe ndërkulturore.</p> <p>4. Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit</p> <p>4.1 Objektivat e programit të studimit</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se programi i studimit është strukturuar dhe funksionon në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Organizimi, përmbajtja dhe procedurat e tij përmbushin kërkesat ligjore që</i></p>

	<i>rregullojnë arsimin e lartë në Shqipëri, duke siguruar një kornizë të qartë dhe të qëndrueshme për zhvillimin akademik dhe profesional të studentëve. Kjo përputhshmëri garanton ligjshmërinë e realizimit të programit dhe krijon një mjedis të përshtatshëm për ofrimin e një arsimit cilësor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, si njësia kryesore përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi”, përbëhet nga tre departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit, ▪ Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sportit, si dhe ▪ Departamenti i Arteve të Aplikuara. <p>Ky fakultet plotëson në mënyrë të plotë të gjitha kriteret dhe standardet e përcaktuara për ofrimin e këtij programi.</p> <p>Në veçanti, Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit, si njësia bazë përgjegjëse për menaxhimin dhe zbatimin e programit, siguron përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative në fuqi që lidhen me organizimin akademik, strukturën e programit, përbërjen e stafit akademik, si dhe me procedurat e vlerësimit dhe akreditimit. Departamenti funksionon në përputhje të plotë me rregulloret e miratuara në kuadër të ligjit për arsimin e lartë dhe aktet nënligjore përkatëse, duke garantuar mbështetje institucionale të qëndrueshme, burime njerëzore me përgatitje të lartë shkencore dhe kapacitete të nevojshme për ofrimin dhe zhvillimin cilësor të programit.</p> <p>Përveç respektimit të standardeve ligjore për kualifikimin dhe angazhimin e stafit akademik, departamenti është i angazhuar në procese të vazhdueshme të vetëvlerësimit dhe në bashkëpunim me vlerësues të jashtëm, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike dhe efikasitetit në ofrimin e programit. Kjo qasje sistematike dhe e strukturuar garanton një nivel të lartë profesionalizmi dhe ekselence akademike në fushën e Shkencave të Komunikimit.</p>

Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale ku bën pjesë programi i studimit MSC në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu” ka në përbërjen e tij për tri vite akademike staf si më poshtë:

Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale	2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	7	1	7	2
Prof.Asc.Dr	4	-	6	1
Dr/Doc	8	7	7	2
Msc	21	10	20	5
Totali	40	18	40	10

Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit për dy vitet akademike ka në përbërjen e tij:

Tituj/Grada	2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.dr	-		1	-
Prof.Asc.Dr	1		2	-
Dr/Doc	3	2	1	1
Msc	5	2	6	-
Totali	9	4	10	1

E. 7 Rregullore MSH Shkenca Komunikimi

E. 20 CV e stafit - MSH Shkenca Komunikimi

E.5 Rregullore UET

E. 30.2 Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë

E. 30.3 Strategjia-për-sigurimin-e-cilësisë-2023-2028

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi,

Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu”, përmbush në mënyrë të plotë detyrimet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, duke

<p>duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>përfshirë edhe angazhimin e personelit ndihmës akademik dhe administrativ.</p> <p>Neni 45 i Statutit të Universitetit Europian të Tiranës përcakton se personeli ndihmës akademik ndahet në dy kategori kryesore: personel ndihmës akademik me karakter mësimor dhe personel ndihmës akademik me karakter administrativ. Në këtë nen përshkruhen qartë veprimtaritë dhe detyrat funksionale që secila kategori kryen brenda strukturave të institucionit. Kjo ndarje siguron një organizim të qartë dhe efikas të mbështetjes së proceseve akademike dhe administrative, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe menaxhimit brenda universitetit. Stafet ndihmës akademike janë të angazhuar në menaxhimin dhe realizimin e praktikave profesionale, laboratorëve dhe aktiviteteve mësimore që lidhen me përmbajtjen e programit.</p> <p><i>E. 2 Statuti (shqip) _struktura organizative aktuale</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit në UET ka caktuar një koordinator të programit për Masterin e Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu”, i cili është përgjegjës për menaxhimin dhe monitorimin e zhvillimit të programit dhe praktikave profesionale. Koordinatori ka rol kyç në sigurimin e përputhshmërisë së procesit mësimor me objektivat akademike të programit, si dhe në organizimin dhe mbikëqyrjen e bashkëpunimit me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë për realizimin e praktikave profesionale të studentëve. Përgjegjësitet e koordinatorit përfshijnë ndërlidhjen mes stafit akademik, studentëve dhe institucioneve bashkëpunuese, si dhe përgatitjen e raporteve periodike mbi ecurinë e programit dhe integrimin e praktikave në kurrikulë.</p> <p><i>E. 36 Emërimet e koordinatorëve dhe përgjegjësave të grupeve mësimore</i></p> <p><i>E. 7 Rregullore_MSH_Shkenca Komunikimi</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe në vlerësimin e kryer, grupi i vlerësimit të jashtëm konkludon se njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi”, me profile përmbush në mënyrë të plotë kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë. Struktura organizative e departamentit është funksionale dhe karakterizohet nga përgjegjësi të qarta institucionale dhe</i></p>

	<i>akademike. Stafi akademik efektiv është aktivisht i angazhuar në realizimin e objektivave të programit, ndërsa pozicioni i koordinatorit të programit është formalizuar dhe i institucionalizuar përmes rregullores së programit dhe vendimeve të departamentit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	<p>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu”, konkretisht Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit, disponon të gjitha dokumentacionet dhe informacionet e nevojshme lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit. Këto të dhëna janë të qarta, të dokumentuara dhe të aksesueshme përmes rregullores së programit, strukturës së kurrikulës, sillabuseve të miratuara për secilën lëndë, si dhe materialeve informuese që u ofrohen studentëve gjatë gjithë procesit mësimor.</p> <p>Gjithashtu, plani mësimor i programit, i paraqitur në evidencën 14.2 përmban të gjithë përbërësit kyç të programit dhe është hartuar në përputhje të plotë me legjislacionin dhe udhëzimet ligjore në fuqi, duke garantuar kështu cilësinë dhe përputhshmërinë akademike të programit.</p> <p><i>E. 14.2 Plani mësimor – shqip</i> <i>E. 7 Rregullore_MSH_Shkenca Komunikimi</i> <i>E. 19.1 Syllabuset shqip - MSH Shkenca Komunikimi</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile, përmban një plan mësimor të strukturuar dhe të detajuar, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Bazuar në evidencën 14.2 ndarja e lëndëve në module dhe semestra është e qartë dhe e organizuar mirë, duke siguruar një balancë të përshtatshme të ngarkesës akademike dhe një rrjedhë logjike të procesit mësimor.</p> <p>Plani mësimor për secilën lëndë përfshin: emrin e lëndës, emrin e pedagogut përgjegjës, kodin përkatës të lëndës, llojin</p>

	<p>e saj (lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese, etj.), gjuhën e mësimdhënies, klasifikimin sipas grupit të lëndëve, si dhe ndarjen e orëve mes leksioneve dhe seminareve. Gjithashtu, janë specifikuar ngarkesat përkatëse në kredite ECTS, duke pasqyruar në mënyrë të detajuar ndarjen e orëve të kontaktit në auditor dhe punës individuale jashtë tij, duke garantuar kështu një proces mësimor të mirëplanifikuar dhe transparent.</p> <p><i>E. 14.2 Plani mësimor – shqip</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu” përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët në lidhje me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, në përputhje me ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe aktet nënligjore përkatëse. Informimi dhe ndërgjegjësimi i studentëve për ndjekjen e këtij programi realizohet përmes një sërë mekanizmash institucionale:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Organizimit të takimeve informuese në ambientet e UET, ▪ Prezantimeve në institucione të interesuara, ▪ Shpërndarjes së materialeve promociionale (fletëpalosje, broshura, spotesh dhe mesazheve vizive), si dhe ▪ Javëve të regjistrimit, të organizuara me mbështetjen logjistike dhe akademike të stafit përkatës. <p>Kriteret e pranimit janë të përcaktuara në nenet përkatëse të Rregullores së Programit të Studimit dhe në dokumentacionin rregullator të UET. Konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Aplikantët duhet të kenë përfunduar me sukses studimet Bachelor, në një fushë të përafërt me programin e Masterit të Shkencave. ▪ Vlerësohet nota mesatare e ciklit të parë të studimeve, sipas kuotave dhe standardeve të vendosura nga Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit. ▪ Për programet Master i Shkencave, njohja e një prej gjuhëve të BE-së (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht ose spanjisht) përmes një certificate ndërkombëtare është e domosdoshme, sipas udhëzimit të MAS.

	<p>Gjithashtu, UET zbaton procedurat për transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve, sipas rregullore së institucionit dhe udhëzimeve të MAS, për të mundësuar integrimin e studentëve nga programe të tjera të ngjashme brenda dhe jashtë vendit, duke garantuar barazi dhe përputhshmëri akademike.</p> <p><i>E.5 Rregullore UET</i> <i>E. 27.1 Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve</i> <i>E. 7 Rregullore_MSH_Shkenca Komunikimi</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu” ofron informacion të plotë dhe të strukturuar për çdo lëndë përmes syllabuseve të detajuara. Çdo syllabus përmban objektivat specifike të lëndës, përmbajtjen tematike, rezultatet e të nxënësve, metodologjinë e mësimdhënies, si dhe mënyrat e vlerësimit të studentëve. Përveç kësaj, syllabuset përfshijnë edhe përcaktimin e praktikave, seminarëve, orëve laboratorike dhe komponentëve të tjerë formues, të cilat janë të dizajnuara për të siguruar një përgatitje të plotë akademike dhe praktike të studentëve, në përputhje me standardet dhe kërkesat e programit të ciklit të dytë të studimeve. Dokumentacioni përkatës i syllabuseve është i organizuar dhe i ruajtur në dosjen e programit, duke i mundësuar studentëve një orientim të qartë dhe transparencë të plotë mbi përmbajtjen dhe kërkesat e procesit mësimor.</p> <p><i>E. 19.1 Syllabuset shqip - MSH Shkenca Komunikimi</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu” është subjekt i një procesi të vazhdueshëm vlerësimi dhe përmirësimi, në përputhje me standardet akademike dhe nevojat e tregut profesional. Në fillim të çdo viti akademik, Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit shqyrton dhe miraton çdo ndryshim të mundshëm në strukturën dhe përmbajtjen e programit, duke marrë parasysh analizat dhe rekomandimet e nxjerra gjatë zbatimit të vitit akademik paraprak. Të gjitha modifikimet dokumentohen dhe ruhen në dosjen përkatëse të programit, duke siguruar kështu gjurmueshmëri dhe transparencë institucionale.</p>

	<p>Gjatë vizitës së grupit të vlerësimit të jashtëm u verifikua se procesi i rishikimit periodik është një praktikë e mirë e institucionalizuar, e kryer kryesisht para fillimit të vitit akademik, çka ndihmon në garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programit dhe përshtatjen e tij me kërkesat dhe zhvillimet më të fundit në fushën e komunikimit. Në kuadër të Procesit Ndërkombëtar të Vlerësimit të Cilësisë për Universitetin Europian të Tiranës, dokumentimi dhe arkivimi i dosjes së programit të studimit në gjuhën angleze është një praktikë standarde dhe e domosdoshme për të garantuar transparencën dhe aksesin ndërkombëtar. Kjo qasje siguron që informacionet mbi strukturën, përmbajtjen dhe ndryshimet e programit të jenë të qasshme për auditorët, partnerët akademikë dhe organizatat ndërkombëtare, duke fuqizuar bashkëpunimin akademik dhe harmonizimin me standardet evropiane dhe globale të arsimit të lartë. Përmes këtij procesi, UET-ja siguron një bazë të fortë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të tij të studimit.</p> <p><i>E. 37 Formatit Raporti i Vlerësimit të Programeve të Lëndëve</i> <i>E. 37.1 Raporti i vlerësimit të programeve të lëndëve</i> <i>E. 38 Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit MSH</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Komunikimi" me profile: "Marrëdhënie Publike Politike", "Menaxhim Marketingu" është i strukturuar dhe organizuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe objektivat formuese të ciklit të dytë të studimeve. Ai siguron informacion të plotë dhe të qartë mbi përmbajtjen e programit, planin mësimor, programet lëndore dhe procedurat akademike përkatëse.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu”, është konceptuar dhe organizuar në përputhje me standardet akademike kombëtare dhe ndërkombëtare, i orientuar drejt zhvillimit të njohurive të avancuara dhe aftësive profesionale. Emërtimi i programit reflekton qartë fushën e studimit dhe objektivat formues, ndërsa përmbajtja e veprimtarive mësimore, akademike dhe kërkimore është e shpërndarë në mënyrë të balancuar ndërmjet komponentëve teorikë dhe atyre praktikë.</p> <p>Struktura e programit përfshin lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe plotësuese, të cilat ndërtojnë progresivisht kapacitetet e studentëve për të analizuar, interpretuar dhe aplikuar njohuritë në kontekste komplekse të komunikimit publik, politik dhe të marketingut. Praktika profesionale me 12 kredite ECTS dhe punimi i diplomës me 18 ECTS përbëjnë komponentë të rëndësishëm për zhvillimin e aftësive kërkimore dhe përgatitjen për tregun e punës apo studime të mëtejshme doktorale.</p> <p>Përmes kësaj qasjeje të integruar dhe të mirëstrukturuar, programi synon jo vetëm përgatitjen e studentëve për rolet profesionale në fushën e marrëdhënieve publike politike dhe menaxhimit të marketingut, por edhe pajisjen e tyre me kompetenca të avancuara që mundësojnë vijimin e studimeve në ciklin e tretë.</p> <p><i>E. 14.2 Plani mësimor – shqip</i> <i>E. 19.1 Syllabuset shqip - MSH Shkenca Komunikimi</i></p>								
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, përfshirë planin mësimor për vitin akademik 2024–2025 (Evidenca E.14.2), grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se programi Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile, përmbush plotësisht kërkesat ligjore dhe standardet e përcaktuara në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, për elementet kryesore të programeve të studimit. Programi është i organizuar në 2 vite akademike (4 semestra) dhe i strukturuar në 120 ECTS, të ndara në kategori funksionale që respektojnë kufijtë ligjorë.</p> <table border="1" data-bbox="608 1668 1374 1874"> <thead> <tr> <th>Kategoria</th> <th>ECTS</th> <th>Përqindja</th> <th>Kufiri ligjor (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A. Lëndë bazë</td> <td>12</td> <td>10%</td> <td>5%–10%</td> </tr> </tbody> </table>	Kategoria	ECTS	Përqindja	Kufiri ligjor (%)	A. Lëndë bazë	12	10%	5%–10%
Kategoria	ECTS	Përqindja	Kufiri ligjor (%)						
A. Lëndë bazë	12	10%	5%–10%						

	B. Lëndë karakterizuese	60	50%	50%–60%
	C. Lëndë ndërdisiplinore	18	15%	12%–20%
	D. Lëndë plotësuese (praktika)	12	10%	10%
	E. Detyrime përmbyllëse	18	15%	10%–15%
	Totali	120	100%	
	<p>Shpërndarja në semestra dhe balanca mes orëve në auditor dhe punës së pavarur sigurojnë arritjen e objektivave formues dhe rezultateve të pritshme të nxënit dhe kërkimit shkencor. Përqendrimi në lëndë kyçe si “Metoda kërkimi në shkencat sociale”, “Analizë kritike e ligjërimit”, “Praktikumi i të shkruarit krijues” dhe “Punimi i diplomës” garanton zhvillimin metodologjik dhe profesional të studentëve. Struktura e programit mundëson progres akademik të qëndrueshëm dhe përgatitje të avancuar në fushën e komunikimit.</p> <p><i>E. 14.2 Plani mësimor – shqip</i></p>			
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Bazuar në analizën e dokumentacionit për programin master i shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu”, struktura e tij akademike është hartuar në përputhje me profilin specifik të programit dhe standardet e programeve të ngjashme ndërkombëtare. Raporti ndërmjet komponentëve teorikë dhe praktikë është i ekuilibruar, duke siguruar një zhvillim të plotë të njohurive dhe aftësive të nevojshme për kërkimin shkencor dhe praktikën profesionale në fushën e komunikimit.</p> <p>Në veçanti, komponenti praktik, i integruar nëpërmjet praktikës profesionale dhe detyrave praktike, kontribuon në formimin e kompetencave të specializuara, duke e bërë programin të përshtatshëm për përgatitjen e profesionistëve të kualifikuar në tregun aktual të punës dhe kërkesave akademike. Për më tepër, përmbajtja dhe niveli i lëndëve reflektojnë kërkesat e avancuara akademike dhe profesionale, duke garantuar që studentët të fitojnë aftësi të thelluara profesionale.</p> <p><i>E. 14.2 Plani mësimor – shqip</i> <i>E. 4.1 Objektivat e programit të studimit</i></p>			

<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit karakterizohet nga një ndarje e qartë dhe e balancuar midis veprimtarive teorike dhe praktike, duke siguruar arritjen e objektivave të formimit akademik dhe profesional. Struktura modulare përbëhet nga lëndë bazë, karakterizuese dhe ndërdisiplinore, me një total prej 120 ECTS, të shpërndara në mënyrë harmonike gjatë katër semestreve. Programi përfshin orë të dedikuara për leksione, seminare, projekte kërkimore dhe praktikë profesionale, duke siguruar kështu një raport të drejtë midis punës në auditor (rreth 718 orë) dhe punës së pavarur (rreth 782 orë).</p> <p>Në fokus janë lëndë metodologjike, lëndë të specializuara dhe lëndë praktike e ndërdisiplinore, të cilat mbështesin zhvillimin e aftësive kërkimore dhe analitike të studentëve. Përveç kësaj, programi është i projektuar për të lehtësuar mobilitetin akademik dhe transferimin e krediteve, duke u harmonizuar me standardet kombëtare dhe praktikatat ndërkombëtare, si dhe përgatit studentët për sfidat e tregut të punës dhe vazhdimin e studimeve të avancuara.</p> <p><i>E. 14.2 Plani mësimor – shqip</i> <i>E. 4.1 Objektivat e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Programeve të Lëndëve (Evidenca 37), grupi i vlerësimit të jashtëm vlerëson se syllabuset e programit master i shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu” përditësohen rregullisht, duke reflektuar nevojat e tregut të punës dhe zhvillimet më të fundit akademike dhe profesionale.</p> <p>Në përputhje me Statutin e UET-së, pikat e parimeve për ndërtimin e programeve të lëndëve garantojnë integrimin e literaturës bazë dhe ndihmëse bashkëkohore, si dhe metodave pedagogjike moderne që synojnë zhvillimin e kompetencave praktike dhe teorike të studentëve. Procesi i përditësimit është i dokumentuar dhe i monitoruar përmes raporteve vjetore të vetëvlerësimit dhe vlerësimeve të jashtme, ku adresohen edhe sugjerimet për përmirësime të mëtejshme.</p> <p>Ky mekanizëm i përditësimit sistematik të syllabuseve siguron që përmbajtja akademike mbetet relevante, duke përgatitur studentët për sfidat reale të profesionit dhe duke i pajisur ata me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për punësim efektiv në fushën e komunikimit.</p>

	<p><i>E. 37 Formati_Raporti i Vlerësimit të Programeve të Lëndëve</i> <i>E. 37.1 Raporti i vlerësimit të programeve të lëndëve</i> <i>E. 30.12 Shembull _Relacion për monitorimin e silabuseve - Sem II _23-24</i> <i>E. 2 Statuti (shqip) _struktura organizative aktuale</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu” është hartuar për t’i ofruar studentëve njohuri të thelluara teorike dhe praktike në fushën e komunikimit, me fokus të veçantë në dy profile kryesore: “Marrëdhënie Publike Politike” dhe “Menaxhim Marketingu”. Programi siguron një mjedis mësimor inovativ dhe ndërdisiplinor, ku studentët fitojnë kompetenca të thelluara në aspektet kritike, etike dhe metodologjike të komunikimit. Rezultatet e pritshme të të nxënësve përfshijnë zhvillimin e aftësive analitike dhe praktike për projektimin dhe zbatimin e aktiviteteve komunikative, menaxhimin e mediave dhe reputacionit politik, si dhe përdorimin e metodave dhe mediave të integruara në marketingun bashkëkohor.</p> <p>Fokusi i dyfishtë i programit i përgatit studentët për të demonstruar njohuri kritike të industrive të komunikimit dhe për të zhvilluar kompetenca të avancuara në menaxhimin e marrëdhënieve politike publike dhe aktiviteteve marketingu. Për më tepër, programi siguron aftësi praktike për menaxhimin e komunikimit politik dhe ndikimin në diskursin publik, si dhe zbatimin e strategjive efektive të komunikimit marketingut.</p> <p>Mundësitë e punësimit që ofrohen për studentët që mbarojnë programin përfshijnë sektorë të ndryshëm publikë dhe privatë, si agjenci informacioni, zyra shtypi, organizata mediatike, radio, televizione, si dhe shtyp të shkruar, duke garantuar përgatitjen e nevojshme për tregun e punës dhe kërkesat profesionale të fushës së komunikimit.</p> <p>Përmbajtja e programit demonstroi qartazi që përfitimi i dijeve, aftësive dhe kompetencave është i garantuar në nivel teorik, metodologjik dhe praktik, në përputhje me objektivat akademike dhe nevojat e tregut profesional.</p> <p><i>E. 14.2 Plani mësimor – shqip</i> <i>E. 4.1 Objektivat e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit</p>	<p>Përmbajtja e programit është e strukturuar në mënyrë që të sigurojë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për vijimin e</p>

<p>mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>suksesshëm të studimeve të avancuara akademike, si dhe për përgatitjen e studentëve për tregun e punës. Programi ofron një kurrikul të balancuar ndërdisiplinore, që adreson kërkesat bashkëkohore të industrive të komunikimit, duke u fokusuar në zhvillimin e kompetencave teorike, metodologjike dhe praktike. Përmes profileve të specializuara në “Marrëdhënie Publike Politike” dhe “Menaxhim Marketingu”, studentët fitojnë njohuri të thelluara dhe aftësi profesionale të nevojshme për aktorët relevantë në sektorin publik dhe privat. Struktura dhe përmbajtja e programit i mundëson përfituesit e diplomës jo vetëm të vazhdojnë studimet në nivele më të larta, por edhe të integrohen me sukses në tregun e punës, në role që kërkojnë ekspertizë të thelluar në komunikim, menaxhim dhe marrëdhënie me publikun.</p> <p><i>E. 14.2 Plani mësimor – shqip</i> <i>E. 4.1 Objektivat e programit të studimit</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e këtij programi studimi janë në harmoni me objektivat arsimore të ciklit të dytë dhe me nivelin e kualifikimit të përcaktuar nga Kuadri Kombëtar dhe ai Evropian i Kualifikimeve. Programi ndihmon në zhvillimin e aftësive akademike dhe profesionale të studentëve, duke garantuar arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit, si dhe mundëson vazhdimësinë e studimeve të mëtejshme ose integrimin efektiv në tregun e punës. Përmbajtja e programit është e orientuar drejt përgatitjes së studentëve sipas nevojave aktuale të tregut dhe zhvillimeve të fundit në fushën e shkencave të komunikimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.5 Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës,</p>	<p>Procesi i përmirësimit dhe përshtatjes së përmbajtjes së programit të studimit zhvillohet nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë me aktorë kyç të tregut të punës, duke përfshirë Bordin e Tregut të Punës, Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, si dhe përmes ngjarjeve të</p>

<p>gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>rëndësishme si Panairi i Karrierës dhe Forumi 500+. Këto platforma ofrojnë mundësi të vazhdueshme konsultimi dhe dialogu me përfaqësues të industrisë, ish-studentë dhe partnerë strategjikë, të cilët kontribuojnë në identifikimin e nevojave të tregut dhe trendeve profesionale. Njësitë përgjegjëse për hartimin dhe zhvillimin e programit angazhohen në mbledhjen, analizimin dhe integrimin sistematik të propozimeve në kurrikulën akademike, duke garantuar kështu përputhshmërinë midis teorisë dhe praktikës dhe përgatitjen optimale të studentëve për sfidat reale profesionale.</p> <p><i>E. 12.1 Bordi i tregut të punës 2024- 2025</i> <i>E. 12 Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit</i> <i>E. 12.2 Axhenda Bordi i tregut të punës</i> <i>E. 12.2 Mbledhje Bordi 2024-2025</i> <i>E. 12.3 Poster Panairi i Karrierës 2024</i> <i>E. 12.5 Forumi 500+</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni promovon aktivisht përfshirjen e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në proceset e vlerësimit dhe përmirësimit të programit të studimit. Përmes takimeve të hapura, siç dokumentohet në evidencën 12.6 që përmban mbledhjen e hapur me studentët, krijohen hapësira dialogu dhe konsultimi të vazhdueshme ku dëgjohen sugjerimet dhe shqetësimet e studentëve. Po ashtu, institucioni mban kontakte të rregullta me studentët e diplomuar, duke përdorur feedback-un e tyre për të adresuar nevojat dhe përmirësimet e mundshme në kurrikulë dhe metodologji mësimore. Kjo qasje gjithëpërfshirëse garanton që programi të jetë i adaptuar dhe në linjë me pritshmëritë dhe përvojat e komunitetit studentor, duke përmirësuar kështu cilësinë dhe efektivitetin e procesit mësimor.</p> <p><i>E. 12.6 Mbledhje e hapur me studentët</i> <i>E. 12 Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në</p>	<p>Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit, përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e programit të studimit, angazhohet në përmirësimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të kurrikulës në përputhje me zhvillimet më të fundit në fushën e komunikimit. Ky proces realizohet përmes bashkëpunimit të ngushtë me rrjete profesionistësh,</p>

<p>fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>institucione publike dhe private, si dhe me anëtarët e Bordit të Tregut të Punës, një organ konsultativ i krijuar për të garantuar lidhjen e programit me kërkesat reale të tregut. Bordi i Tregut të Punës ofron feedback të rregullt dhe rekomandime të bazuara në nevojat e punëdhënësve dhe zhvillimet profesionale në fushë. Departamenti integron sistematikisht këto propozime në strukturën dhe përmbajtjen e programit, duke siguruar që formimi të jetë i përditësuar, relevant dhe në harmoni me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo qasje garanton cilësi të lartë arsimore dhe përgatitje profesionale që i përgjigjet pritshmërive të tregut të punës.</p> <p><i>E. 12.1 Bordi i tregut të punës 2024- 2025</i> <i>E. 12 Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit</i> <i>E. 12.2 Axhenda Bordi i tregut të punës</i> <i>E. 12.2 Mbledhje Bordi 2024-2025</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se institucioni ka marrë hapa të konsoliduara për të siguruar përfshirjen aktive të studentëve, të diplomuarve, partnerëve institucionalë, rrjeteve profesionale dhe organizatave lokale e ndërkombëtare në procesin e zhvillimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të programit të studimit. Ky angazhim ka luajtur një rol kyç në arritjen e objektivave formues të programit dhe në përshtatjen e tij me nevojat e tregut të punës, duke forcuar kështu cilësinë dhe relevancën e tij, si në aspektin akademik, ashtu edhe në atë profesional.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--

<p>Standardi II.6 Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat</p>	<p>Programi i studimit shpreh në mënyrë të qartë dhe të strukturuar prioritetet dhe objektivat kryesore të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor, duke reflektuar në mënyrë të</p>




<p>kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>vazhdueshme vizionin dhe misionin strategjik të institucionit. Ky përcaktim i qartë i qëllimeve dhe përmbajtjes akademike siguron që programi të jetë në harmoni me synimet zhvillimore të universitetit, duke i përmbushur nevojat e tregut të punës dhe kërkesat specifike të fushës së studimit. Për më tepër, ky proces i integruar garanton një zhvillim të qëndrueshëm akademik, i cili pasqyron trendet bashkëkohore në shkencë dhe praktikat më të mira në edukimin universitar. Në këtë mënyrë, programi jo vetëm që kontribuon në ngritjen e cilësisë së arsimit të lartë, por edhe i përgatit studentët në mënyrë efektive për sfidat profesionale dhe kërkimore që do të përballen në të ardhmen.</p> <p><i>E. 4.1 Objektivat e programit të studimit</i> <i>E.2 Statuti (shqip)_struktura organizative aktuale</i> <i>E.3 Plani Strategjik UET 2021-2025</i> <i>E. 3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025</i> <i>E.5 Rregullore UET</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit, si njësi bazë përgjegjëse për zbatimin e programit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu”, ushtron funksionet e saj në përputhje me kuadrin ligjor dhe institucional, duke mbështetur zhvillimin e veprimtarive të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Këto veprimtari organizohen në përputhje me natyrën ndërdisiplinore të programit dhe synojnë nxitjen e kompetencave akademike dhe profesionale të studentëve, si dhe respektimin e lirisë akademike të stafit, të garantuar nga Statuti i Universitetit European të Tiranës, rregullorja e brendshme dhe Kodi i Etikës.</p> <p>Struktura organizative e fakultetit karakterizohet nga një veçori: Dekani i Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale mban njëkohësisht edhe funksionin e Shefit të Departamentit të Shkencave Humane dhe Komunikimit. Ky konfigurim, në një strukturë me përmasa mesatare (rreth 30 staf akademik dhe tre departamente përbërëse), ka rezultuar i dobishëm në drejtim të koordinimit dhe efikasitetit vendimmarrës. Ky organizim ka lehtësuar linjën e komunikimit dhe ka përforcuar përputhshmërinë midis strategjisë institucionale dhe zbatimit akademik.</p> <p>Gjatë takimeve të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm në institucion, nuk u evidentuan shqetësime apo ankesa nga stafi akademik mbi këtë organizim. Megjithatë, duke marrë parasysh përqendrimin e funksioneve vendimmarrëse në një</p>

	<p>individ të vetëm, vlerësohet e rëndësishme që institucioni të garantojë dhe të dokumentojë ekzistencën dhe funksionalitetin e mekanizmave të pavarur për adresimin e ankesave dhe mbrojtjen e lirisë akademike.</p> <p><i>E.2 Statuti (shqip)_struktura organizative aktuale</i> <i>E. 43 Kërkimi Shkencor 2019-2024</i> <i>E. 3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Programi i studimit nxit dhe motivon studentët për angazhim aktiv në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore, siç evidentohen edhe në mbledhjet e organizuara nga Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit. Për shembull, në datën 31/01/2025, mbledhja e hapur me studentët dhe ajo e Bordit të Tregut të Punës trajtoi pikërisht përfshirjen e studentëve në projektet kërkimore dhe publikimet shkencore, si dhe evidentimin e çështjeve të lidhura me ecurinë mësimore. Kjo dëshmon përkushtimin institucional për të integruar studentët në procesin kërkimor dhe për të adresuar në mënyrë aktive nevojat dhe shqetësimet e tyre, duke përforcuar kështu realizimin e këtij kriteri.</p> <p><i>E. 12.6 Mbledhje e hapur me studentët</i> <i>E. 3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025</i></p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Njësia bazë për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore dhe shkencore ka mbështetje të qëndrueshme financiare nga institucioni, i cili garanton burimet e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe kërkimor. Përveç financimit nga buxheti i institucionit, Departamenti administron në mënyrë transparente të ardhurat e gjeneruara nga aktivitete të ndryshme, përfshirë projekte kërkimore dhe bashkëpunime me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë. Ky model menaxhimi financiar kontribuon në sigurimin e një mjedisi të favorshëm për zhvillimin e aktiviteteve akademike dhe kërkimore, duke mbështetur kështu arritjen e objektivave strategjike të njësisë dhe institucioni në përgjithësi.</p> <p><i>E. 3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se programi i studimit ofron një drejtim të qartë dhe të strukturuar në fushën akademike dhe kërkimore, duke integruar në mënyrë efektive përmbajtjen e lëndëve, projektet praktike, angazhimin në aktivitete kërkimore, si dhe bashkëpunimet me ekspertë dhe institucione të specializuara në fushën e komunikimit.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7 Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Grupi i vlerësimit të jashtëm vlerëson se njësia përgjegjëse mbështet aktivisht grupet lëndore dhe projektet e reja kërkimore-shkencore, duke siguruar bashkëpunim të frytshëm me struktura të tjera kërkimore brenda dhe jashtë institucionit. Përmes pjesëmarrjes në Programin e Madh Kërkimor 2021-2025, veçanërisht në projektin “Roli i individit në zhvillimin e shoqërisë shqiptare”, ku fokusi është në praktikat e komunikimit në media, aktorë dhe institucione kulturore, njësia garanton realizimin e objektivave kërkimore të programit të studimit. Ky angazhim ndërdisiplinor dhe integrimi i doktorantëve në grupet kërkimore theksojnë përkushtimin e njësisë për avancimin shkencor dhe zbatimin e kërkimeve empirike në fushën e komunikimit.</p> <p><i>E. 3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025</i> https://uet.edu.al/projektet-e-grupet-kerkimore/</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit angazhohet aktivisht në realizimin e analizave, studimeve dhe projekteve kërkimore në përputhje me kërkesat aktuale, duke përfshirë personelin akademik dhe studentët në këto procese. Ky bashkëpunim pasqyrohet edhe në pjesëmarrjen e stafit dhe studentëve në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, ku prezantohen rezultatet e kërkimeve dhe promovohen projektet shkencore. Gjithashtu, në planin e integruar të aktiviteteve të fakultetit 2024-2025 theksohet se një nga objektivat kryesore është nxitja dhe mbështetja e kërkimit shkencor dhe projekteve kërkimore. Plani synon të strukturojë në mënyrë të organizuar aktivitetet mësimore, kërkimore dhe bashkëpunimet ndërdisiplinore, duke inkurajuar përfshirjen aktive të stafit akademik dhe studentëve në zhvillimin e studimeve dhe projekteve shkencore që kontribuojnë në avancimin e njohurive në fushat përkatëse.</p> <p>Përmes përfshirjes së personelit akademik dhe të studentëve në këto procese forcohet përvoja kërkimore dhe nxitet zhvillimi i</p>

	<p>kompetencave analitike dhe shkencore. Praktikrat kërkimore shpesh lidhen edhe me projektet në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit, duke mundësuar një ndërthurje të qëllimeve akademike me nevojat reale të shoqërisë dhe tregut të punës.</p> <p><i>E. 28.1 Projekte UET 2017-2024</i> <i>E. 34 Lista e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit</i> <i>E. 55 Ditët e Studimeve Shqiptare DSSH 2025</i> <i>E. 56 Formati i planit të integruar të aktiviteteve FSHHEA draft 2024 2025</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit organizon rregullisht konferenca dhe aktivitete akademike që kontribuojnë në arritjen e objektivave të programit të studimit. Këto aktivitete përfshijnë seminare, tryeza diskutimi dhe konferenca shkencore, ku përfshihet personeli akademik, studentët dhe ekspertë të fushës. Përmes këtyre aktiviteteve, nxitet shkëmbimi i njohurive, promovohen praktikrat më të mira kërkimore dhe forcohet lidhja mes teorisë dhe praktikës.</p> <p><i>E. 55 Ditët e Studimeve Shqiptare DSSH 2025</i> <i>E. 56 Formati i planit të integruar të aktiviteteve FSHHEA draft 2024 2025</i> <i>E. 33 Të dhënat për trajnime profesionale për stafin dhe ose studentët</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Programi i studimit është hartuar për të formuar profesionistë të aftë dhe konkurrues në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës, duke ofruar një kurrikulë të balancuar midis njohurive teorike dhe aftësive praktike. Përmbajtja akademike, e përforcuar me praktika profesionale, projekte kërkimore dhe bashkëpunime me aktorë të industrisë, siguron që studentët të jenë të përgatitur për sfidat reale të fushës së komunikimit. Gjithashtu, programi promovon zhvillimin e kompetencave ndërdisiplinore dhe aftësive kritike, që i mundësojnë të diplomuarve të përshtaten lehtësisht në mjedise pune dinamike dhe të avancojnë karrierën në nivel ndërkombëtar. Për më tepër, lidhjet me rrjete profesionale dhe mundësitë për mobilitet akademik forcojnë më tej pozicionin e tyre konkurrues në tregun e punës.</p> <p><i>E. 14.2 Plani mësimor – shqip</i> <i>E. 4.1 Objektivat e programit të studimit</i> <i>E. 28.1 Projekte UET 2017-2024</i> <i>E. 34 Lista e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit</i></p>

<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit merr parasysh rekomandimet dhe standardet e vendosura nga institucionet dhe organizatat profesionale gjatë hartimit dhe përditësimit të programeve të studimit. Edhe pse programet nuk janë të lidhura direkt me marrjen e licencave profesionale, ato përshtaten me zhvillimet dhe kërkesat më të fundit të tregut dhe profesioneve përkatëse, duke siguruar kështu që studentët përgatiten me kompetencat e nevojshme dhe njohuritë bashkëkohore për t'u integruar me sukses në mjedisin profesional. Ky proces garanton një lidhje të qëndrueshme midis përmbytjes akademike dhe nevojave reale të fushës së komunikimit.</p> <p><i>E. 14.2 Plani mësimor – shqip</i> <i>E. 4.1 Objektivat e programit të studimit</i></p>			
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Programi i studimit është zhvilluar duke marrë në konsideratë zhvillimet ligjore dhe rekomandimet ndërkombëtare relevante, pavarësisht se diplomohet në fushën e “Shkencës së Komunikimit”, e cila nuk është një profesion i rregulluar me ligj. Në përgatitjen e programit është vënë theksi në përshtatjen me standardet evropiane për kualifikime dhe kompetenca, duke synuar që studentët të jenë të përgatitur për sfidat e tregut të punës dhe për mundësi të ndryshme profesionale, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar.</p> <p><i>E. 14.2 Plani mësimor – shqip</i> <i>E. 4.1 Objektivat e programit të studimit</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Grupi i vlerësimit të jashtëm evidenton se programi i studimit garanton njohuri të thelluara në fushën e Shkencave të Komunikimit, integron elemente ndërkombëtarizimi përmes bashkëpunimeve dhe referencave me standarde dhe praktika ndërkombëtare, si dhe promovon kërkimin shkencor si pjesë thelbësore të procesit arsimor.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	---

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu”, i ofruar nga Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit zbaton një gamë të gjerë formash të mësimdhënies dhe mësimnxënies, të cilat janë në përputhje me standardet bashkëkohore akademike dhe të miratuara nga institucioni. Format përfshijnë leksione teorike, seminare interaktive, punë praktike dhe projekte kërkimore, si dhe angazhim aktiv të studentëve në detyra të strukturuar (projekte, raste studimore, prezantime). Gjithashtu, në strukturën e programit është e parashikuar edhe komponenti i praktikës profesionale, si një formë integruese që mundëson aplikimin e njohurive në mjedise reale pune. Orët e hapura dhe takimet me ekspertë të fushës, të kombinuara me përdorimin e metodave të mësimdhënies të orientuara drejt studentit kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave kritike, analitike dhe kërkimore të studentëve. Format e integruara të mësimdhënies e bëjnë programin gjithëpërfshirës dhe të përshtatshëm me natyrën akademike të ciklit të dytë të studimeve.</p> <p><i>E. 7 Rregullore_MSH_Shkenca Komunikimi</i> <i>E. 19.1 Syllabuset shqip - MSH Shkenca Komunikimi</i> <i>E. 14.2 Plani mësimor – shqip</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik i përfshirë në programin e studimit përshtat metodat e mësimdhënies me nevojat e ndryshme të studentëve, duke respektuar parimin e diversitetit dhe përfshirjes në procesin mësimor. Kjo reflektohet edhe në ndërtimin e syllabuseve të lëndëve, ku përcaktohen qartë objektivat e të nxënit, format alternative të vlerësimit, burimet ndihmëse dhe metodologjitë e ndryshme të të mësuarit, si leksione interaktive, punë në grup, punë</p>

	<p>individuale, raste studimore. Gjithashtu, përdoren platforma digjitale dhe materiale të shumëllojshme ndihmëse për të siguruar akses të barabartë në përmbajtjen mësimore dhe për të nxitur përfshirjen aktive të studentëve.</p> <p>Në rastet kur është e nevojshme, ofrohen konsultime individuale duke mundësuar mbështetje të vazhdueshme për studentët. Këto forma të adaptuara të mësimdhënies u konfirmuan edhe nga vetë studentët gjatë vizitës që grupi i vlerësimit të jashtëm zhvilloi në institucion, ku u evidentua vlerësimi pozitiv i tyre për fleksibilitetin pedagogjik, qasjen gjithëpërfshirëse të stafit akademik dhe përpjekjet për t’iu përshtatur nevojave të ndryshme individuale të studentëve. Ky feedback përforcon vlerësimin se programi mbështetet në parime bashkëkohore të mësimdhënies, duke respektuar diversitetin dhe duke promovuar përfshirjen e plotë të studentëve në procesin akademik.</p> <p><i>E. 7 Rregullore_MSH_Shkenca Komunikimi</i> <i>E. 19.1 Syllabuset shqip - MSH Shkenca Komunikimi</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit mbështet zhvillimin e vazhdueshëm të kompetencave didaktike të personelit akademik, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit të përcaktuara në programin e studimit. Kjo mbështetje realizohet nëpërmjet organizimit të trajnimeve periodike, seminareve mbi metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies, si dhe pjesëmarrjes së stafit në konferenca dhe aktivitete të zhvillimit profesional, brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Gjithashtu, nëpërmjet mekanizmave të brendshëm të vlerësimit akademik (si analiza vjetore e programeve të lëndëve, diskutimet pedagogjike në mbledhjet e departamentit dhe vlerësimi nga studentët), institucioni nxit përmirësimin e praktikave didaktike dhe përshtatjen e tyre me nevojat reale të studentëve dhe zhvillimet në fushën e komunikimit. Evidencat e përfshira në raportim tregojnë se stafi akademik mbështetet në mënyrë aktive në përmirësimin e aftësive të tyre pedagogjike, duke kontribuar në cilësinë dhe efektivitetin e procesit mësimor.</p> <p><i>E. 3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025</i> https://uet.edu.al/projektet-e-grupet-kerkimore/ <i>E. 28.1 Projekte UET 2017-2024</i> <i>E. 55 Ditët e Studimeve Shqiptare DSSH 2025</i></p>

	<p><i>E. 33 Të dhënat për trajnime profesionale për stafin dhe ose studentët</i></p> <p><i>E. 38 Analiza e departamentit përgjegjes mbi arritjen e objektivave formuese të programit MSH</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te studenti mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Stafi akademik i përfshirë në programin e studimit master i shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile është kompetent për transmetimin e njohurive dhe koncepteve teorike e praktike, duke përdorur një shumëllojshmëri metodash bashkëkohore të mësimdhënies që vendosin studentin në qendër të procesit mësimor. Mësimdhënia realizohet përmes leksioneve interaktive, diskutimeve, analizës së rasteve konkrete, punës në grup, projekteve të pavarura dhe përfshirjes aktive të studentëve në diskutime kritike dhe analitike. Kjo qasje metodologjike synon të zhvillojë te studentët mendimin kritik, kreativitetin, si dhe autonominë dhe përgjegjësinë akademike. Për më tepër, syllabuset e lëndëve të programit pasqyrojnë qartë objektivat formuese dhe format interaktive të të nxënësve që promovojnë angazhim të vazhdueshëm.</p> <p>Stafi akademik luan një rol aktiv në udhëheqjen akademike, përmes mentorimeve individuale, mbështetjes në realizimin e praktikave profesionale dhe orientimit në përgatitjen e punimeve kërkimore. Marrëdhëniet mes stafit akademik dhe studentëve karakterizohen nga komunikimi profesional, aspekte të cilat u konfirmuan nga studentët gjatë vizitës në institucion. Praktikant institucionale të mbledhjeve të hapura me studentët dhe përfshirjes së tyre në aktivitete kërkimore, siç evidentohet në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni vlerësohen pozitivisht.</p> <p><i>E. 19.1 Syllabuset shqip - MSH Shkenca Komunikimi</i> <i>E. 20 CV e stafit - MSH Shkenca Komunikimi</i> <i>E. 12.6 Mbledhje e hapur me studentët</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit realizon vlerësimin dhe përmirësimin periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies, duke përfshirë studentët në mënyrë aktive në këtë proces. Kjo realizohet përmes vlerësimeve semestrale të lëndëve, mbledhjeve të hapura me studentët (si ajo e mbajtur më 31 janar 2025), diskutimeve në nivel departamenti, si dhe anketave të dedikuara për vlerësimin e praktikave profesionale dhe komponentëve mësimorë.</p>

	<p>Të dhënat e mbledhura nga këto instrumente analizohen dhe pasqyrohen në raportet e vetëvlerësimit të lëndëve dhe në dokumente të tilla si “Formati i Planit të Integruar të Aktiviteteve” i Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale. Këto analiza ndihmojnë në përmirësimin e syllabuseve, në rishikimin e metodave të vlerësimit dhe në shtimin e formave alternative të mësimdhënies.</p> <p><i>E. 12.6 Mbledhje e hapur me studentët</i> <i>E. 38 Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit MSH</i> <i>E. 37.1 Raporti i vlerësimit të programeve të lëndëve</i> <i>E. 30.12 Shembull _Relacion për monitorimin e silabuseve - Sem II 23-24</i> <i>E. 30.3 Strategjia-për-sigurimin-e-cilësisë-2023-2028</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Për realizimin e Kriterit 6, Universiteti European i Tiranës ka ngritur dhe funksionalizuar struktura të dedikuara në nivel institucional, të cilat synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe koordinimin e aktiviteteve me njësitë bazë. Një nga strukturat kyçe në këtë drejtim është Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), i miratuar me vendim të Senatit Akademik nr. 05, datë 30.03.2023, dhe i përbërë nga përfaqësues të të gjitha fakulteteve, përfshirë edhe përfaqësues të studentëve dhe një ekspert të jashtëm ndërkombëtar (Prof. Dr. phil. Stefan Handke – TÛ Dresden). KSBC ka një rol aktiv në mbikëqyrjen dhe përmirësimin e metodologjive të mësimdhënies, përmes instrumenteve si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Monitorimi dhe analiza e syllabuseve, duke përdorur një matricë përputhshmërie me rezultatet e të nxënit dhe objektivat e programit (evidenca 30.10 dhe 30.12); ▪ Kontrolli i proceseve të provimeve, përmes metodologjisë së qartë dhe formateve standarde të raportimit (30.5 dhe 30.6); ▪ Zhvillimi i fokus grupeve me studentët dhe shpërndarja e raporteve të detajuara me njësitë akademike (30.13, 30.14, 30.15); ▪ Komunikimi sistematik i rekomandimeve për përmirësim me departamentet, nëpërmjet raporteve mbi syllabuset, provimet dhe të dhënat nga vlerësimi i studentëve.

	<p>Gjithashtu, përmes Planit të Veprimit të KSBC dhe Strategjisë për Sigurimin e Cilësisë 2023–2028, institucioni ka përshkruar qartë qëllimin për të mbështetur zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe për të ofruar trajnime për personelin akademik. Këto aktivitete realizohen në bashkëpunim të ngushtë me njësitë bazë. Në këtë mënyrë, institucioni jo vetëm garanton zbatimin e standardeve të brendshme të cilësisë, por edhe promovon një kulturë të qëndrueshme reflektimi, zhvillimi dhe inovacioni në mësimdhënie.</p> <p><i>E. 8 Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë</i> <i>E. 30 Të dhëna për anëtarët e KSBC</i> <i>E. 30.1 Plani veprimit KSBC</i> <i>E. 30.2 Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë</i> <i>E. 30.3 Strategjia-per-sigurimin-e-cilesise-2023-2028</i> <i>E. 30.4 Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC</i> <i>E. 30.5 Metodologjia e punës së KSBC provimet</i> <i>E. 30.6 Format raporti për kontrollin e provimeve</i> <i>E. 30.7 Shembull Komunikime dhe shpërndarja e raportit të KSBC mbi provimet</i> <i>E.30.9 Metodologjia e punës së KSBC_Silabuset</i> <i>E.30.10 Format_Matrica e përputhshmërisë së silabuseve</i> <i>E. 30.11 Shembull Komunikime dhe shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset</i> <i>E. 30.12 Shembull Relacion për monitorimin e silabuseve - Sem II 23-24</i> <i>E. 30.13 Metodologjia e punës së KSBC_Fokus Grup</i> <i>E. 30.14 Shembull Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve</i> <i>E. 30.15 Shpërndarja e raportit dhe ekstrakt raporti i fokus grupeve</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se institucioni ka garantuar plotësisht një proces të të nxënit të fokusuar tek studenti, duke përdorur metoda bashkëkohore dhe aktivitete praktike që nxisin zhvillimin e aftësive profesionale dhe shkencore. Syllabuset janë të strukturuar qartë dhe përmbajnë rezultate të matshme të të nxënit, ndërsa përfshirja e studentëve në projekte dhe kërkime përmirëson cilësinë e mësimdhënies. Institucioni siguron një mjedis që promovon mendimin kritik dhe përgatitje konkurruese për tregun e punës.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Në përputhje me Rregulloren e Universitetit Europian të Tiranës, sistemi i vlerësimit të studentëve është i strukturuar dhe funksionon në mënyrë transparente, duke përfshirë forma të ndryshme të kontrollit të vazhdueshëm të dijeve dhe aftësive. Kjo përfshin leksione, seminare, detyra kursi, projekte praktike, provime ndërmjetëse dhe përfundimtare, si dhe praktika profesionale. Qëllimi kryesor i këtij sistemi është të sigurojë një vlerësim objektiv dhe stimulues të performancës akademike të studentëve, duke i nxitur ata të angazhohen gjatë gjithë periudhës së studimeve dhe të zhvillojnë aftësitë analitike, kritike dhe praktike. Të gjitha kriteret dhe mënyrat e vlerësimit janë publike dhe bëhen të njohura për studentët në fillim të çdo kursi.</p> <p>Në kuadër të programit të studimit master i shkencave në “Shkenca Komunikimi”, të dy profilet kryesore “Marrëdhënie Publike Politike” dhe “Menaxhim Marketingu” kanë udhëzime të posaçme të cilat përcaktojnë detajet e procesit të vlerësimit, të përshtatura për karakteristikat dhe kërkesat specifike të secilit profil. Këto udhëzime përcaktojnë metodologjinë e kontrollit të vazhdueshëm të dijeve dhe aftësive, duke përfshirë provimet, mënyrat e vlerësimit të punimeve praktike, projektet kërkimore dhe mënyrën e zhvillimit të seminareve interaktive.</p> <p><i>E. 5 Rregullore UET</i> <i>E. 7 Rregullore_MSH_Shkenca Komunikimi</i> <i>E. 7.2 Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve</i> <i>E. 15.1 Suplement Udhëzimi 11 - MSh Shkenca komunikimi_Menaxhim marketingu</i> <i>E. 15.2 Suplement Udhëzimi 11 - MSh Shkenca komunikimi_Marrëdhënie publike politike</i></p>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me	Në përputhje me standardet akademike të Universitetit Europian të Tiranës, në fillim të çdo lënde apo moduli, studentët njoftohen në mënyrë të detajuar nga titullari i

<p>metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>lëndës/modulit lidhur me metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore. Këto informacione janë përfshirë në syllabuset përkatëse të lëndëve ose moduleve, të cilat janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe transparente. Njohja paraprake me kriteret dhe mënyrat e vlerësimit ndihmon studentët të kuptojnë pritshmëritë akademike dhe të organizojnë më mirë procesin e tyre të të nxëniet, duke rritur kështu efektivitetin e përgatitjes dhe performancës gjatë kursit.</p> <p><i>E. 7 Rregullore MSH Shkenca Komunikimi</i> <i>E. 15.1 Suplement Udhëzimi 11 - MSh Shkenca komunikimi Menaxhim marketingu</i> <i>E. 15.2 Suplement Udhëzimi 11 - MSh Shkenca komunikimi Marrëdhënie publike politike</i> <i>E. 19.1 Syllabuset shqip - MSH Shkenca Komunikimi</i></p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore në Universitetin Europian të Tiranës realizohet përmes formave dhe metodave të ndryshme, të përshtatura për të siguruar një vlerësim gjithëpërfshirës dhe të drejtë të performancës studentore. Kjo përfshin provime të ndërmjetme dhe përfundimtare, detyra kursi, ese, prezantime, projekte praktike, punë në grup, praktika profesionale dhe vlerësime me karakter aplikativ. Përdorimi i formave të ndryshme të vlerësimit ofron mundësi për studentët që të demonstrojnë në mënyrë të plotë njohuritë e fituara, si dhe zhvillimin e kompetencave të tyre analitike, kritike dhe profesionale.</p> <p><i>E. 7.2 Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se institucioni ka hartuar dhe miratuar rregullore dhe procedura të qarta dhe të detajuara për testimin dhe vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore. Këto dokumente janë të disponueshme publikisht dhe janë të njohura nga studentët dhe stafi akademik. Zbatimi i këtyre procedurave monitorohet dhe kontrollohet rregullisht për të siguruar standardet më të larta cilësore.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.3 Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Kriteri konsiderohet i realizuar, pasi procesi i testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit akademik. Syllabuset e lëndëve përmbajnë qartësisht komponentët e vlerësimit, si dhe peshën e secilit element për vlerësimin përfundimtar. Kjo qasje siguron një monitorim të vazhduar të përparimit të studentëve dhe krijon një lidhje funksionale midis mësimdhënies dhe rezultateve të të nxënit. <i>E. 7 Rregullore_MSH_Shkenca Komunikimi</i> <i>E. 19.1 Syllabuset shqip - MSH Shkenca Komunikimi</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Në raportin e vlerësimit të brendshëm të institucionit theksohet se, në bashkëpunim me AADF, është zhvilluar sistemi i vlerësimit Clean Scoring, i cili synon të sigurojë një proces më transparent dhe objektiv të vlerësimit të studentëve. Megjithatë, ky sistem nuk aplikohet në të gjitha lëndët e programit. Duke marrë parasysh natyrën specifike të programit të studimit, kjo praktikë konsiderohet e pranueshme dhe në përputhje me nevojat e fushës, duke lejuar fleksibilitet në përdorimin e metodave të ndryshme të vlerësimit sipas karakteristikave të secilës lëndë. <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm – Master Shkcor “Shkenca Komunikimi”, Standardi III.3, Kriteri 2, f. 44</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Kriteri konsiderohet i realizuar, pasi vlerësimi përfundimtar i lëndëve realizohet në përputhje me përcaktimet e bëra në syllabus përkatës dhe në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Titullarët e lëndëve respektojnë komponentët e vlerësimit të përcaktuar në syllabus, duke siguruar transparencë, objektivitet dhe trajtim të barabartë të studentëve në procesin e vlerësimit. Kjo u konfirmua edhe nga takimi me studentët gjatë vizitës në institucion. <i>E. 7 Rregullore_MSH_Shkenca Komunikimi</i> <i>E. 19.1 Syllabuset shqip - MSH Shkenca Komunikimi</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me	Kriteri konsiderohet i realizuar, pasi në procesin e vlerësimit parashikohet dhënia e komenteve dhe feedback-ut individual nga titullarët e lëndëve, veçanërisht në rastet e detyrave me karakter analitik apo praktik. Ky feedback ndihmon studentët

<p>komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>të kuptojnë pikat e tyre të forta dhe ato që kërkojnë përmirësim, duke e orientuar procesin e tyre të të nxënësve drejt arritjes së rezultateve më të mira në të ardhmen. Kjo u konfirmua edhe nga takimi me studentët gjatë vizitës në institucion.</p> <p><i>E. 7 Rregullore_MSH_Shkenca Komunikimi</i> <i>E. 19.1 Syllabuset shqip - MSH Shkenca Komunikimi</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Njësia përgjegjëse dhe stafi akademik në Universitetin Europian të Tiranës zbatojnë masa strikte për parandalimin e plagjiaturës, kopjimit dhe sjelljeve të tjera të palejueshme gjatë provimeve dhe detyrave akademike. Sipas rregullores së institucionit dhe programit të studimit, hyrja në provim është e lejuar vetëm për studentët që kanë përmbushur detyrimet akademike dhe financiare, duke garantuar kështu seriozitetin e procesit. Gjatë provimeve, studentët kontrollohen me rigorozitet; ata duhet të paraqiten me dokument identifikimi dhe ndahen në banka sipas regjistrimit alfabetik. Çantat, materialet mësimore dhe telefonat celularë vendosen në vend të veçantë dhe telefonat fiken plotësisht, për të shmangur çdo tentativë për kopjim, ndërsa shkeljet e këtyre rregullave penalizohen me përjashtim nga provimi dhe vlerësim minimal. Gjithashtu, në sallën e provimit lejohen vetëm personat e autorizuar, duke ruajtur integritetin e procesit. Pedagogët kanë përgjegjësinë të informojnë studentët në fillim të çdo provimi për rregullat e sjelljes gjatë testimit.</p> <p>Sa i përket kontrollit të plagjiaturës, sistemi LMS i UET integron në mënyrë efektive mjete për verifikimin e origjinalitetit të punimeve. Këto mjete lejojnë pedagogët të kontrollojnë nëse detyrat e dorëzuara nga studentët përmbajnë përmbajtje të kopjuar ose të papërshtatshme, duke kontribuar kështu në mbajtjen e standardeve të larta akademike.</p> <p><i>E. 7.2 Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit të dijeve në programin e studimit ofrohen në mënyrë transparente dhe objektive, duke u bazuar plotësisht në meritën e studentëve. Koha e shpalljes së rezultateve është e përcaktuar qartë në rregulloret e institucionit dhe respektohet rigorozisht, duke siguruar që studentët të marrin informacionin për performancën e tyre brenda afateve të paracaktuara. Nga takimet me studentët u</p>

	<p>konfirmua se përgjithësisht vlerësimet e personalit akademik ishin objektive.</p> <p><i>E. 7 Rregullore_MSH_Shkenca Komunikimi</i></p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur në mënyrë të plotë dhe transparente me rezultatet e vlerësimit, duke siguruar akses të lehtë në informacionin për performancën akademike. Në përputhje me Statutin, rregulloret dhe procedurat e brendshme të vlerësimit, studentëve u ofrohet mundësia për të kërkuar rishikimin e rezultateve në rastet e dyshimit apo mospajtimeve. Procesi i ankesave menaxhohet në mënyrë formale dhe të strukturuar, përmes formularit për ankesat e studentëve, i cili siguron trajtim të drejtë dhe të paanshëm të çdo shqetësimi, duke kontribuar në mbrojtjen e të drejtave të studentëve dhe rritjen e besueshmërisë së sistemit të vlerësimit akademik.</p> <p><i>E. 0.2 D-VI-3-3 Formular per ankesat e studenteve _ Departamenti</i></p>			
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>E drejta e kërkesës dhe ankesës njihet dhe rregullohet në Rregulloren e programit të studimit, ku parashikohet ngritja e komisionit për shqyrtimin e ankimeve të studentëve. Procedura e trajtimit të ankimeve është transparente, dokumentohet dhe arkivohet sipas nenit 32 të Rregullores së Universitetit European të Tiranës, duke garantuar trajtim të drejtë dhe të paanshëm të çdo kërkesë apo ankimi.</p> <p><i>E. 7 Rregullore_MSH_Shkenca Komunikimi</i> <i>E. 5 Rregullore UET</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se institucioni siguron një proces vlerësimi transparent, i cili bazohet në meritën individuale të çdo studenti. Për më tepër, procesi i ankimit është i njohur dhe i zbatueshëm në praktikë, me procedura të qarta dhe të dokumentuara që garantojnë trajtim të drejtë të çdo kërkesë. Kjo qasje kontribuon në ruajtjen e cilësisë akademike dhe besueshmërisë së sistemit të vlerësimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu” garanton thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve përmes një strukture të pasur dhe të ekuilibruar të lëndëve që mbulojnë metodat kërkimore në shkencat sociale, teoritë e komunikimit, menaxhimin e fushatave, etikën dhe lidhshimin në organizata, marketingun dixhital dhe strategjitë për mediat e reja, si dhe komunikimin masiv bashkëkohor. Për më tepër, programi përfshin bashkëpunime aktive me media dhe organizata të ndryshme, si dhe angazhimin në projekte kërkimore dhe shkencore që u mundësojnë studentëve të zhvillojnë përvojë praktike dhe të forcojnë aftësitë e tyre profesionale. Përveç kësaj, programi integron lëndë ndërdisiplinore si diplomacia publike, marrëdhëniet publike politike dhe menaxhimin e eventeve, si dhe praktika profesionale dhe punimin e diplomës që konsolidojnë njohuritë dhe aftësitë kërkimore dhe shkencore të fituara gjatë studimeve.</p> <p><i>E. 14.2 Plani mësimor – shqip</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaja).</p>	<p>Programi i studimit në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu” garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fusha kyçe si teknologjia e informacionit, shkencat humane dhe sociale, si dhe komunikimi dhe ndërveprimi efektiv. Përmes moduleve të specializuara si marketingu dixhital, strategjitë e komunikimit për mediat e reja, komunikimi masiv bashkëkohor dhe praktikën e integruara në menaxhimin e eventeve dhe marrëdhëniet publike, studentët zhvillojnë kompetenca të avancuara në përdorimin e teknologjive moderne të informacionit dhe mjeteve digjitale. Gjithashtu, programi përfshin zhvillimin e aftësive në komunikimin ndërpersonal dhe ndërkulturor, duke përfshirë përdorimin e gjuhëve të huaja, për të përgatitur profesionistë të aftë për të punuar në një mjedis global dhe multikulturor.</p> <p>Plani Strategjik i Universitetit Europian të Tiranës, në pikën I.2, përcakton që çdo program studimi, deri në vitin 2025, duhet të ofrojë deri në 25% të lëndëve në gjuhën angleze, duke marrë në konsideratë pjesëmarrjen në programet Erasmus dhe synimin për ndërkombëtarizimin e universitetit.</p>

	<p><i>E. 3 Plani Strategjik UET 2021-2025</i> <i>E. 14.2 Plani mësimor – shqip</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Ky kriter konsiderohet i realizuar në mënyrë të plotë. Kompetencat dhe aftësitë që studentët fitojnë gjatë zhvillimit të çdo lënde analizohen dhe vlerësohen në përfundim të saj përmes instrumenteve të ndryshme si testime, ese, projekte praktike, prezantime dhe diskutime në klasë. Personeli akademik informon dhe udhëzon studentët lidhur me rëndësinë praktike të këtyre njohurive dhe kërkesat që duhet të plotësojnë për t'u certifikuar me sukses në lëndë.</p> <p><i>E. 7.2 Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve</i> <i>E. 7 Rregullore_MSH_Shkenca Komunikimi</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuar kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit mbështet një proces mësimdhënieje të strukturuar mbi bazën e zhvillimit të kompetencave praktike dhe teorike të studentëve, duke përfshirë edhe praktikat profesionale dhe aktivitetet laboratorike që i mundësojnë atyre aplikimin e njohurive në situata reale. Personeli akademik ka një rol aktiv në udhëheqjen e diskutimeve, nxitjen e punës në grupe dhe stimulimin e mendimit kritik dhe krijues, duke krijuar një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e aftësive profesionale dhe kërkimore.</p> <p>Për më tepër, Departamenti inkurajon bashkëpunimin me institucione partnere dhe organizata jashtë institucionit, siç janë mediat lokale dhe ndërkombëtare, organizatat joqeveritare dhe institucionet kulturore, duke ofruar mundësi për mobilitet akademik dhe përvojë praktike të zgjeruar për studentët. Shembuj konkretë janë projektet kërkimore të zhvilluara në kuadër të bashkëpunimit me media dhe institucione kulturore, si dhe organizimi i seminarëve dhe trajnimeve me profesionistë të fushës, që kontribuojnë në përgatitjen e studentëve për sfidat e tregut të punës.</p> <p>Gjithashtu, infrastruktura bashkëkohore dhe teknologjia e avancuar e disponueshme në departament mbështesin në mënyrë efektive procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke krijuar kushte optimale për adaptimin ndaj kërkesave të tregut të punës dhe sfidave shkencore bashkëkohore.</p> <p><i>E. 14.2 Plani mësimor – shqip</i></p>

	<p><i>E. 33 Të dhënat për trajnime profesionale për stafin dhe ose studentët</i></p> <p><i>E. 34 Lista e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit</i></p> <p><i>E. 42 Infrastruktura në funksion të programeve të studimit_Blv. Gjergj Fishta</i></p> <p><i>E. 42.1 Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”E. 28.1 Projekte UET 2017-2024</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit organizon rregullisht orë të hapura dhe seminare, ku personeli akademik efektiv dhe me kontratë prezanton zhvillimet më të fundit në fushën e shkencës dhe teknologjisë, duke përfshirë edhe tendencat në komunikim, media dhe teknologjitë digjitale. Këto aktivitete realizohen brenda dhe jashtë strukturës së programit të studimit, duke synuar informimin e studentëve dhe stafit mbi avancimet aktuale dhe nxitjen e një kulture kërkimore dhe inovacioni. Për më tepër, seminarët shpesh organizohen në bashkëpunim me institucione kërkimore, ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë, duke kontribuar kështu në zhvillimin profesional dhe shkencor të komunitetit akademik. Ndër të tjera, evidenca e analizës së Departamentit të Shkencave Humane dhe Komunikimit shërben si dokument mbështetës që vërteton dhe ilustron realizimin e Kriterit 5, duke ofruar prova konkrete për arritjen e objektivave formuese të programit, përfshirë organizimin e orëve të hapura dhe seminareve mbi zhvillimet e reja shkencore dhe teknologjike nga personeli akademik efektiv dhe me kontratë.</p> <p><i>E. 38 Analiza e departamentit pergjegjes mbi arritjen e objektivave formuese të programit MSH</i></p> <p><i>E. 33 Të dhënat për trajnime profesionale për stafin dhe ose studentët</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025 dhe Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit, promovojnë zhvillimin e ideve inovative dhe studimeve të avancuara kërkimore nga studentët. Këto dokumente strategjike përcaktojnë objektivat kryesore të programit të studimit dhe përfshijnë mekanizma të qartë për mbështetjen financiare dhe institucionale të iniciativave kërkimore të studentëve, duke nxitur kështu një mjedis akademik të frytshëm dhe novator.</p> <p><i>E. 3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025</i></p> <p><i>E. 4 Plani Strategjik per Zhvillimin e Programit te Studimit</i></p>

Konkluzione	<i>Programi i studimit përmbush kërkesat e standardit duke siguruar thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve. Ai bazohet në një metodologji mësimdhënieje që fokusohet tek kompetencat, përfshin praktika profesionale dhe përdor një infrastrukturë moderne. Personeli akademik luan një rol aktiv në procesin e zhvillimit të studentëve, ndërsa programi nxit krijimin e ideve inovative dhe pjesëmarrjen e tyre në kërkimin shkencor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe e bën atë publike.	Neni 8, pika 1 e Rregullores së Programit të Studimit për Masterin e Shkencave në: “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu” përcakton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, e cila publikohet para realizimit të tyre. Institucioni ka hartuar një procedurë të qartë dhe të detajuar për detyrimet përmbyllëse, duke përfshirë punimin e diplomës me vlerë 18 kredite. Kjo procedurë përcakton hapat dhe kriteret që studentët duhet të ndjekin gjatë realizimit të punimit përmbyllës dhe është në dispozicion të plotë për studentët, duke garantuar transparencë dhe njohje të mirëfilltë të kërkesave dhe afateve për mbarëvajtjen e procesit. Gjithashtu, personeli akademik ofron mbështetje dhe udhëzime gjatë gjithë fazës së përgatitjes së punimit, duke kontribuar në zhvillimin akademik dhe profesional të studentëve. <i>E. 7 Rregullore MSH Shkenca Komunikimi</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Strukturat përgjegjëse, në bashkëpunim të ngushtë me personelin akademik, sigurojnë asistencë të vazhdueshme dhe mbështetje të personalizuar për studentët gjatë fazës së përgatitjes së detyrimeve përmbyllëse. Udhëzuesit për hartimin e punimit të diplomës, dokumentacioni mbështetës dhe modelet e vlerësimit janë të aksesueshme dhe lehtësisht të disponueshme për studentët, ndërsa pedagogët udhëheqës ofrojnë orientim dhe ndihmë individuale për çdo fazë të punimit dhe shkrimit të diplomës.

	<p><i>E. 10 Dokumenti B. II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit</i></p> <p><i>E. 15 Modeli i diplomës</i></p> <p><i>E. 15 Modeli i diplomës 2</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në këtë program studimi, nuk parashikohet provimi përfundimtar; në vend të tij, detyrimi përmbyllës realizohet përmes mbrojtjes së tezës së diplomës. Teza përfaqëson një punim profesional dhe kërkimor që reflekton në mënyrë të plotë profilin praktik dhe akademik të ciklit të studimeve. Procesi i administrimit të mbrojtjes menaxhohet nga një komision i posaçëm, i ngritur sipas rregullores së studimeve, i cili vlerëson njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e fituara nga studenti gjatë gjithë ciklit. Vlerësimi bazohet në përmbajtjen dhe thellësinë e temës, cilësinë e analizës, aplikimin praktik të njohurive profesionale, si dhe përgatitjen për tregun e punës. Ky proces zhvillohet në përputhje me standardet akademike dhe rregulloret institucionale, duke siguruar një vlerësim objektiv, të drejtë dhe gjithëpërfshirës të performancës përfundimtare të studentit.</p> <p><i>E. 7 Rregullore MSH Shkenca Komunikimi</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit, në përputhje me Rregulloren e Universitetit European të Tiranës (neni 39, pika 3 dhe 4), ka përcaktuar qartë udhëzimet lidhur me kriteret që duhet të përmbushin tezat e diplomës dhe detyrimet e pedagogut udhëheqës. Gjithashtu, Rregullorja e programit të studimit në Shkenca Komunikimi (neni 8, pika 4 dhe 5) parashikon rolin aktiv të personelit akademik në orientimin dhe asistencën ndaj studentëve për zgjedhjen e temave, nxjerrjen dhe përpunimin e rezultateve, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës në përputhje me udhëzuesit zyrtarë.</p> <p>Udhëheqësi i punimit të diplomës orienton studentët në përzgjedhjen e temës, strukturimin e përmbajtjes, kërkimin dhe përpunimin e të dhënave. Gjithashtu, ndihmon studentët në zhvillimin e aftësive analitike dhe kritike, duke i inkurajuar ata të përdorin metoda kërkimore të përshtatshme dhe burime të besueshme. Udhëheqësi garanton cilësinë akademike të punimit përmes konsultimeve të rregullta dhe vetëm pas vlerësimit të përmbajtjes dhe rezultateve lejon ose jo kalimin për mbrojtje.</p>

	<p><i>E. 5 Rregullore UET</i> <i>E. 7 Rregullore MSH Shkenca Komunikimi</i> <i>E. 10 Dokumenti B. II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Universiteti European i Tiranës siguron mbështetje të vazhdueshme logjistike dhe teknike për studentët gjatë realizimit të kërkimeve, analizave, matjeve dhe testeve të nevojshme për punimet e diplomës, në përputhje me natyrën dhe kërkesat e temave të tyre. Kjo mbështetje ofrohet brenda ambienteve të institucionit, të pajisura me infrastrukturë bashkëkohore, laboratorë funksionalë dhe mjete teknologjike moderne, si dhe në bashkëpunim me institucione publike ose private, në varësi të profilit të kërkimit. Përmes këtij sistemi mbështetës krijohen kushtet optimale për zhvillimin e kërkimit aplikativ dhe realizimin cilësor të detyrimeve përmbyllëse, duke u përmbushur objektivat akademike të programit të studimit.</p> <p><i>E. 10 Dokumenti B. II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit</i> <i>E. 42.1 Infrastruktura në funksion të programeve të studimit</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të mbrojtjes së punimit të diplomës studenti vlerësohet me notë sipas kriterëve të përcaktuara në rregullore. Procesi i vlerësimit është i dokumentuar dhe i bazuar në performancën akademike dhe përmbajtjen e paraqitur.</p> <p><i>E. 7 Rregullore_MSH_Shkenca Komunikimi</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Universiteti European i Tiranës, pas përfundimit me sukses të programit të studimit, pajis studentin me diplomën përkatëse dhe suplementin e diplomës në përputhje me formatet zyrtare të miratuara, duke reflektuar profilizimin e studimeve: Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profil: “Marrëdhënie Publike Politike” dhe Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profil: “Menaxhim Marketingu”. Gjithashtu, studentit i vihet në dispozicion një kopje zyrtare e listës së notave.</p> <p><i>E. 15 Modeli i diplomës/ Modeli i diplomës 2</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të</p>	<p>Institucioni respekton legjislacionin në fuqi për arkivimin dhe ruajtjen e dokumentacionit të studentëve. Të dhënat e detyrimeve përmbyllëse, si dhe vlerësimet, ruhen në formë</p>

studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	fizike dhe paraqiten në rastet kur kërkohen nga studentët ose autoritetet përkatëse. <i>E. 5 Rregullore UET</i> <i>E. 9 Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore</i>			
Konkluzione	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se institucioni garanton mbështetje akademike, teknike dhe procedurale për realizimin e detyrimeve përmbyllëse, duke siguruar cilësi dhe infrastrukturë të përshtatshme për studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	NA
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	NA
Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në	NA

dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.				
Konkluzione				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1				
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, rezulton se për realizimin e këtij programi studimi janë angazhuar pedagogë me tituj dhe grada shkencore, dhe konkretisht: Ne cilësinë e stafit akademik efektiv, në vitin 2024-2025 (por edhe një vit më parë është ruajtur i njëjti raport), nga 10 pedagogë të angazhuar, me statusin PAE rezulton 1 pedagog me titullin akademik “Profesor”, 3 pedagogë me titullin akademik “Profesor i Asociuar” dhe 6 pedagogë me gradën shkencore “Doktor”. Ndërsa stafi PAK përbëhet nga 1 pedagogë me titullin akademik “Profesor i Asociuar”, 1 pedagog me gradën shkencore “Doktor” dhe 1 pedagog i nivelit “Master i Shkencave”. Përbërja e këtij stafi është e profileve të ndryshme akademike, kryesisht në shkencë humane dhe në shkencat e komunikimit, por edhe në fushat e mësimdhënies që përputhen me hartimin e kurrikulës së këtij programi. Evidenca që lidhet me CV e stafit, justifikon në mënyrë të detajuar edhe disiplinat ku janë specializuar të japin mësim ligjëruesit në këtë program.			
		2022-2023	2023-2024	2024-2025

60

ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof.Dr	1	-	2	1	1	-
	Prof.As.Dr	2	-	2	1	3	1
	Dr	4	1	7	1	6	1
	MSc	3			1		1
	Total	10	1	10	4	10	3

E. 38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit
E. 20. CV e stafit MSh Shkenca Komunikimi

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Institucioni garanton që personeli akademik aktual të përmbushë në mënyrë të plotë dhe në përputhje me ligjin ngarkesën mësimore të programit të studimit. Të dhënat e disponueshme pasqyrojnë nivelin e lartë akademik të stafit të angazhuar, ku pjesa më e madhe është e punësuar me kohë të plotë në Universitetin Europian të Tiranës. Dokumentacioni tregon gjithashtu se PAE mbulon rreth 85% të ngarkesës mësimore, ndërsa PAK përfaqëson rreth 15%, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

E. 0.2 Tabela përmbledhëse për Aneks
E. 38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit
E. 20. CV e stafit MSh Shkenca Komunikimi

Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

Bazuar në analizën e departamentit për periudhën 2018-2025, rezulton se institucioni ka siguruar qëndrueshmëri të personelit akademik efektiv. Gjatë periudhës së akreditimit, stafi është punësuar në përputhje me procedurat e rregullta, me kontrata ligjore dhe pagesa të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, duke respektuar dispozitat ligjore dhe rregulloret institucionale. Për personelin akademik me tituj dhe grada shkencore, kontratat janë pa afat; për PAE pa grada dhe tituj, kontratat janë njëvjeçare; ndërsa për PAK, kontratat janë semestrale me të drejtë rinovimi. Të gjitha kontratat nënshkruhen nga Rektori. Statuti, Rregulloret e Institucionit dhe Kodi i Etikës përbëjnë dokumentet bazë që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e stafit akademik dhe shërbejnë si bazë për hartimin e kontratave të punës.

E.2 Statuti i Universitetit Europian të Tiranës.
E.7 Rregullore mësimore e programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në "Shkenca Komunikimi"

	<p><i>E. 16. A. II. Kodi i Etikës</i> <i>E. 38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit</i> <i>E. 11. G. Rregullore për burimet njerëzore</i> <i>E.44.1 Lista e dokumentacionit që përmban dosja e stafit PAE</i> <i>E.44.2 Lista e dokumentacionit që përmban dosja e stafit PAK</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Dokumentet e brendshme të institucionit përcaktojnë se vlerësimi i stafit kryhet jo vetëm gjatë procesit të rekrutimit, por edhe gjatë gjithë periudhës së punës. Thirrjet për rekrutim bëhen duke marrë parasysh nevojat konkrete të departamentit, ekspertizën e kandidatëve dhe ngarkesën mësimore. Qëllimi është përzgjedhja e personelit me kualifikimet e nevojshme, në përputhje me përmbajtjen e programit të studimit. Institucioni angazhohet për menaxhimin efikas të burimeve njerëzore, duke ndjekur procedurat ligjore të rekrutimit dhe duke ofruar mbështetje për zhvillimin profesional të stafit. Përzgjedhja e stafit realizohet në mënyrë transparente, përmes ngritjes dhe funksionimit të një komisioni të caktuar nga njësi përkatëse.</p> <p><i>E.11. G. Rregullore për burimet njerëzore</i> <i>E.2 Statuti i Universitetit European të Tiranës</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka siguruar kushtet me personel ndihmës të mjaftueshëm dhe të kualifikuar për realizimin e orëve laboratorike dhe ka garantuar ambiente të pajisura me aparatura, mjete dhe programe aplikative të përshtatshme me nevojat e studentëve për aftësim praktik.</p> <p><i>E.42.1 Infrastruktura akademike në funksion të programit</i></p>

<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjisllacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Të dhënat e personelit mblidhen çdo vit akademik nga Zyra e Burime Njerëzore, e cila krijon Dosjen Individuale të Stafit Akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, ku depozitohet i gjithë dokumentacioni si dhe pjesëmarrja në konferenca shkencore, publikimet, realizimi i ngarkesës mësimore, aktivitetet dhe projektet kërkimore, CV e përditësuar. Në këto të dhëna bazohet Drejtuesi i Departamentit për të ndarë ngarkeën ndërmjet anëtarëve të stafit PAE dhe PAK.</p> <p><i>E.44.1 Lista e dokumentacionit që përmban dosja e stafit akademik me kohë të plotë</i></p> <p><i>E.6 Dokument mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit</i></p> <p><i>E.11.G. Rregullore për burimet njerëzore</i></p> <p><i>E 11.2 Formular për ngarkesën (orë në auditor) e stafit akademik që mbulon lëndët e departamentit</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin,</p>	<p>Nëpërmjet bashkëpunimeve institucionale dhe marrëveshjeve, institucioni siguron personel të kualifikuar për instruktim, udhëheqje dhe mbikëqyrje të studentëve gjatë praktikës profesionale, punimit të diplomës dhe veprimtarive të tjera të integruara në programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu”. Numri i pedagogëve mbikëqyrës përcaktohet në varësi të numrit të studentëve. Më tej këta pedagogë udhëheqës janë pjesë edhe e komisionit që ngre Departamenti për vlerësimin e praktikave mësimore të realizuara nga studentët. Si rregull, kur një student është i angazhuar në punë me kohë të plotë apo të pjesshme, gjatë periudhës së realizimit të praktikave mësimore, studentit puna e tij i njihet si realizim i praktikës mësimore, me kushtin që të jetë e të njëjtit fushë me programin e studimit. Ndërsa për realizimin e udhëheqjes së</p>

<p>udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>diplomave, Drejtuesi i Departamentit cakton një pedagog udhëheqës për çdo student.</p> <p><i>E. 34 Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese.</i> <i>E. 34.1 Memorandum bashkëpunimi mes UET dhe Fondacionit "Fundjavë Ndryshe"</i> <i>E. 34.2 Memorandum bashkëpunimi mes UET dhe Bashkia Tiranë</i> <i>E. 34.3 Memorandum bashkëpunimi mes UET dhe Gazeta Liberale</i> <i>E.34.4 Memorandum bashkëpunimi mes UET dhe Albtelecom</i> <i>E.34.5 Memorandum bashkëpunimi mes EEI dhe Balfin</i> <i>E.34.6 Memorandum bashkëpunimi mes UET dhe UET PRESS</i> <i>E.32.1 Dokumenti mbi praktikat profesionale</i></p>			
<p>Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës ndihmon studentin në përmbushjen e detyrimeve dhe përgatitjen e raportit final dhe gjithashtu merr pjesë në procesin e vlerësimit të praktikës, në bashkëpunim me institucionin. Ata angazhohen nëpërmjet vënies në zbatim të marrëveshjeve të hartuara më parë ndërmjet UET dhe institucionit pritës. Një pjesë e orëve të praktikës realizohen në ambientet e universitetit, ku ekzistojnë të gjitha kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të praktikave mësimore, me mjetet e nevojshme teknologjike që kërkon zhvillimi i sotëm i teknologjisë së komunikimit.</p> <p><i>E. 34 Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese</i> <i>E.42.1 Infrastruktura akademike në funksion të programit</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi Master i Shkencave në "Shkenca Komunikimi" me profile: "Marrëdhënie Publike Politike", "Menaxhim Marketingu" në UET mbështetet nga një staf akademik i qëndrueshëm, me kualifikime të larta dhe përbërje shumë profesionale që siguron mbulim cilësor të disiplinave dhe arritjen e objektivave formuese. Institucioni zbaton rregulla të qarta për rekrutimin dhe zhvillimin profesional të stafit, ofron burime të përshtatshme dhe bashkëpunime me partnerë, duke garantuar përgatitje praktike dhe relevancë në tregun e punës, në përmbushje të plotë të standardeve dhe kërkesave ligjore.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, deri në vitin akademik 2021-2022, në selinë e vjetër në Bulevardin “Gjergj Fishta”, si pjesë e infrastrukturës për programet e studimit, ishin në përdorim: 14 salla seminari me nga 35 vende secila, 9 salla leksionesh dhe seminaresh me kapacitet 70 vende, 3 laboratorë informatike me nga 35 vende, 1 sallë interneti me 80 kompjutera dhe 1 bibliotekë me 150 vende leximi. Ndërsa që nga shtatori 2021, në selinë e re në Rrugën “Xhanfize Keko”, janë funksionale: 13 salla seminari me një kapacitet total prej 353 vendesh, 15 salla leksionesh me gjithsej 1138 vende, 7 laboratorë informatike me 190 vende dhe 1 sallë interneti me 70 vende. Duke qenë se gjatë viteve 2018-2024 në programin Master Shkencor në Shkenca Komunikimi janë regjistruar gjithsej 175 studentë, rezultoi se institucioni ka ofruar mjediset e mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor, si në raport me natyrën specifike të studimit dhe moduleve përkatëse, ashtu edhe me numrin e studentëve të regjistruar në këtë program.</p> <p><i>E. 42 Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i> <i>E.42.1 Infrastruktura në funksion zhvillimit të të programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjediset të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit dhe i infrastrukturës rezultoi se pajisjet dhe mjediset e institucionit janë të përshtatshme dhe përputhen me kërkesat e procesit mësimor. Në çdo ambient mësimor dhe pune janë të instaluar mjete audiovizuale, kompjuterë, projektorë dhe sisteme zanore, të cilat sigurojnë funksionimin normal të veprimtarisë mësimore.</p> <p>Gjithashtu, të gjitha hapësirat janë të pajisura me sisteme kondicionimi dhe mbulohen nga sinjali Wi-Fi, duke mundësuar aksesin e studentëve në platformat online LMS dhe Microsoft Teams.</p> <p><i>E. 42 Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i></p>

<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, afësisimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Është konstatuar se mjediset e institucionit janë të pajisura me aparatura dhe mjete të përshtatshme për përmbushjen e kërkesave të procesit mësimor.</p> <p>Rezulton se institucioni ka mundur furnizimin e këtyre mjediseve me kompjuterë, ka siguruar mirëmbajtjen e tyre, si dhe instalimin dhe përditësimin në kohë të programeve nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit.</p> <p>Gjithashtu, është verifikuar se për lehtësimin e programit mësimor janë instaluar programe aplikative të domosdoshme dhe bashkëkohore, të cilat mbështesin studentët dhe pedagogët në zhvillimin e proceseve akademike.</p> <p><i>E.42.1 Infrastruktura në funksion zhvillimit të të programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Është konstatuar se për asistimin e studentëve të programit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile, institucioni ka vënë në dispozicion laboratorë të teknologjisë së informacionit.</p> <p>Në funksion të këtij programi është inaguruar salla InnoLab, e pajisur me kompjuterë dhe videoprojektor.</p> <p>Gjithashtu, rezulton se në të gjithë institucionin funksionojnë 7 laboratorë informatike, të pajisur me kompjuterë dhe videoprojektorë. Të gjitha këto hapësira janë të pajisura me paketa programesh profesionale, të cilat mbështesin zhvillimin optimal të procesit mësimor.</p> <p><i>E.42.1 Infrastruktura në funksion zhvillimit të të programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e</p>	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe nga rezultatet e vizitës në institucion, rezulton se praktikat mësimore të programit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile zhvillohen në ambientet e institucionit, në salla leksionesh të pajisura me mjetet e nevojshme për realizimin e tyre.</p> <p>Ndërkohë, praktikat profesionale organizohen në institucione të ndryshme, në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit që institucioni ka lidhur me subjekte të fushës përkatëse.</p> <p><i>E. 42 Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i> <i>E. 34 Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese.</i> <i>E. 34.1 Memorandum bashkëpunimi mes UET dhe Fondacionit “Fundjavë Ndryshe”</i></p>

programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	<p><i>E. 34.2 Memorandum bashkëpunimi mes UET dhe Bashkia Tiranë</i></p> <p><i>E. 34.3 Memorandum bashkëpunimi mes UET dhe Gazeta Liberale</i></p> <p><i>E.34.4 Memorandum bashkëpunimi mes UET dhe Albtelecom</i></p> <p><i>E.34.5 Memorandum bashkëpunimi mes EEI dhe Balfin</i></p> <p><i>E.34.6 Memorandum bashkëpunimi mes UET dhe UET PRESS</i></p> <p><i>E.32.1 Dokumenti mbi praktikat profesionale</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Universiteti European i Tiranës ka krijuar një infrastrukturë moderne dhe të zgjeruar në kampusin e ri, e cila ofron ambiente dhe teknologji bashkëkohore të përshtatshme për zhvillimin e programit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu”, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet në fuqi.</i></p> <p><i>Kapacitetet infrastrukturore dhe bashkëpunimet me institucione partnere sigurojnë mbështetje efektive për realizimin e praktikës profesionale dhe për përmbushjen e objektivave të programit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Biblioteka e Universitetit European të Tiranës, e vënë në shërbim të studentëve, disponon literaturë fizike dhe digjitale të nevojshme për mbështetjen e proceseve mësimore dhe për përvetësimin e dijeve të përditësuara në fushën e Shkencave të Komunikimit.</p> <p>Në vitin akademik 2020-2021, fondi i bibliotekës u pasurua me rreth 1,392 artikuj, ndërsa gjatë viteve akademike 2021-2022 dhe 2022-2023 u shtuan edhe 1,708 libra në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj.</p>
	<i>E. 42 Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të	Në lidhje me nevojën për përditësimin e literaturës, njësia përgjegjëse komunikohet me përgjegjësin e bibliotekës për

<p>raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>pasurimin dhe përditësimin e fondit me literaturën e nevojshme, në mënyrë që të sigurohet zhvillimi normal i procesit mësimor dhe mbështetje për aktivitetet kërkimore shkencore.</p> <p>Përgjegjësi i bibliotekës regjistron gjithashtu numrin e kopjeve të reja që hyjnë në fond nga Departamenti, duke marrë parasysh botimin, llotin e librave dhe nevojat e kërkesat e studentëve.</p> <p><i>E-IV Mbi funksionimin e Bibliotekës</i> <i>E. 42 Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Salla e bibliotekës ka një sipërfaqe prej 40 m², ndërsa Salla e Leximit ka një sipërfaqe prej 50 m² dhe ofron 41 vende për lexim. Biblioteka është gjithashtu e pajisur me kompjuterë, të cilët u mundësojnë studentëve akses në bibliotekat online dhe arkivat SAGE dhe EBSCO.</p> <p><i>E-IV Mbi funksionimin e Bibliotekës</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Për vitet akademike 2023-2024 dhe 2024-2025, Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale disponon një fond prej 2,379 librash në gjuhët shqip, anglisht, frëngjisht, gjermanisht dhe italisht.</p> <p>Biblioteka e institucionit ofron kushte optimale për studim dhe punë kërkimore, duke funksionuar me orar të zgjatur dhe duke ofruar akses në programet dhe abonimet elektronike SAGE, EBSCO, Edward Elgar Publishing, ASTM Compass dhe RESEARCH4LIFE.</p> <p>Institucioni ka gjithashtu akses të plotë në pesë platforma elektronike të reja: Edward Elgar Publishing 2, ASTM Compass 2, IOP Science, IOS Science 2 dhe Hein Online's Social Justice Suite. Për të mbështetur nevojat e programeve mësimore, Biblioteka ofron literaturë fizike në gjuhën shqipe dhe të huaj, si dhe botime të UET PRESS, të përzgjedhura për përdorim në syllabuset e lëndëve të programit Master në "Shkenca Komunikimi" me profile: "Marrëdhënie Publike Politike", "Menaxhim Marketingu".</p> <p><i>E. 42 Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në</p>	<p>Të gjitha ambientet e institucionit janë të pajisura me lidhje Wi-Fi, që ofron akses të pandërprerë të studentëve në bibliotekën virtuale.</p>



<p>bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Kompjuterat e vendosur brenda bibliotekës mundësojnë qasje në platformat SAGE, EBSCO, Edward Elgar Publishing, ASTM Compass dhe RESEARCH4LIFE, ku studentët kanë mundësi të konsultojnë mijëra artikuj dhe botime shkencore. Për nevojat e programit Master i Shkencave në: “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu”. Biblioteka ka krijuar një katalog elektronik me libra në gjuhë të huaj, duke mbështetur studimet dhe aktivitetin kërkimor të studentëve.</p> <p><i>E. 42 Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje teknike, që mundësojnë shfrytëzim pa kufizim për të gjithë studentët, duke siguruar akses në katalogët online dhe librat elektronikë. Aty gjenden gjithashtu kompjuterë në numër të mjaftueshëm për të lehtësuar aksesin e vazhdueshëm në bibliotekën virtuale.</p> <p><i>E. 42 Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka është në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve në gjashtë ditët e javës nga e hëna në të premte në oraret 09.00-20.00, ndërsa të shtunën në orarin 10.00-17.00, në përshtatje me programet e studimit, duke përfshirë edhe programin Master i Shkencave në: “ Shkenca Komunikimi” me profile “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu”. Gjatë sezoneve të provimeve ky orar është i zgjatur përtej kohës së zakonshme të shërbimit.</p> <p><i>E. 42 Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të</p>	<p>Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse e programit raportojnë periodikisht mbi cilësinë e fondit fizik dhe atij online, si dhe mbi gjendjen dhe shfrytëzimin e sallave fizike. Njëkohësisht, ato hartojnë planet dhe kërkesat për pasurimin e fondit me artikuj të rinj, si për literaturën fizike, ashtu edhe për atë online.</p> <p><i>E-IV Mbi funksionimin e Bibliotekës</i></p>



studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.									
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, konstatohet se Biblioteka e Universitetit European të Tiranës ofron një strukturë të mirëorganizuar dhe të përditësuar, me fond të pasur librash dhe akses në platformat ndërkombëtare, duke mbështetur në mënyrë efektive studentët e programit Master në Shkenca Komunikimi me profile "Marrëdhënie Publike Politike", "Menaxhim Marketingu". Pajisjet moderne, orari fleksibël dhe bashkëpunimi me njësitë akademike sigurojnë kushte optimale për studim dhe aktivitet kërkimor shkencor. Ky element rezulton i përputhshëm me standardet dhe kërkesat ligjore për funksionimin e bibliotekave akademike</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Të dhënat e studentëve regjistrohen dhe administrohen nga Zyra e Regjistrimit të Studentëve dhe Sekretaria Mësimore e Institucionit, të cilat mbajnë informacion mbi arritjet akademike, si dhe mbi lëshimin e diplomave dhe certifikatave. Studentët regjistrohen gjithashtu në Sistemin e Menaxhimit të Procesit Mësimor (UMIS), ku ruhen të dhënat personale dhe akademike. Staf i akademik ka akses të plotë në databazën "Dokumenta UET", ndërsa studentët mund të konsultojnë informacionin mbi programin e studimit dhe lëndët përkatëse përmes platformës UET LMS. Regjistrimi dhe trajtimi i të dhënave realizohet duke respektuar parimin e konfidencialitetit dhe duke garantuar siguri dhe integritet të informacionit personal.

	<p>Pedagogët e rinj që punësohen në UET janë të detyruar të ndjekin seanca metodologjike për përdorimin e UMIS-it, për të cilin institucioni siguron stafin mbështetës dhe manualin e përdorimit.</p> <p><i>E. E.1 Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.</i> <i>E. 46 Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS</i> <i>E. 16 A.II. Kodi i Etikës UET</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Secila zyrë e stafit akademik të UET është e pajisur me kompjuterë, ku gjendet databaza e institucionit me emërtimin “Dokumenta UET”. Përmes kësaj databaze, secili pedagog mund të aksesojë në kohë reale të dhënat që lidhen me strategjitë, rregulloret, urdhrat administrativë, standardet dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm.</p> <p>Përveç kësaj, sistemi UET LMS përdoret për të mbajtur kontakt me studentët lidhur me materialet e leksioneve dhe seminareve, veprimtaritë mësimore, detyrat e kursit, esetë, tezat e provimit dhe rezultatet e vlerësimit. Komunikimi me studentët mundësohet gjithashtu përmes mjeteve elektronike si email, forum dhe chat.</p> <p>Megjithatë, sikurse u evidentua edhe gjatë vizitës në institucion, UET duhet të ndërmarrë masa shtesë teknike dhe organizative, të cilat parashikojnë njoftimin paraprak dhe marrjen e dakordësisë së personit të përfshirë për verifikimin e të dhënave personale, duke kufizuar aksesin vetëm për personat e autorizuar.</p> <p><i>E. 46 Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS</i> <i>E. 46.2 UET LMS Guidë për pedagogun</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Studentët kanë mundësi të konsultojnë informacionin mbi programin e studimit dhe mbi lëndët përkatëse përmes platformës UET LMS, ku regjistrohen për secilën lëndë, ndërsa personeli i Universitetit ka qasje të plotë në databazën e institucionit të quajtur “Dokumenta UET”.</p> <p><i>E. G. Rregullore për burimet njerëzore</i> <i>E. 46 Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS</i> <i>E. 46.2 UET LMS Guidë për pedagogun</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe</p>	<p>Zyra e Regjistrimit të studentëve regjistron dhe administron të dhënat e studentëve si dhe Sekretaria Mësimore e Institucionit, të cilat mbajnë informacion mbi arritjet akademike, si dhe mbi lëshimin e diplomave dhe certifikatave.</p>

<p>shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Studentët regjistrohen gjithashtu në Sistemin e Menaxhimit të Procesit Mësimor (UMIS), ku ruhen të dhënat personale dhe akademike. Stafi akademik ka akses të plotë në databazën e institucionit “Dokumena UET”, ndërsa studentët mund të konsultojnë informacionin mbi programin e studimit dhe lëndët përkatëse përmes platformës UET LMS.</p> <p>Platforma Microsoft TEAMS u aktivizua gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, për zhvillimin e mësimit online dhe organizimin e takimeve të klubeve studentore.</p> <p>Aktualisht, kjo platformë vazhdon të përdoret për takime me të ftuar të ndryshëm, si dhe për realizimin e aktiviteteve të tjera mësimore dhe jashtëmësimore në distancë.</p> <p><i>E. 56.1. Kalendar i aktiviteteve të departamentit të Shkencave Humane dhe Komunikimit</i></p> <p><i>E. 46.2 UET LMS Guidë për pedagogun</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Institucioni monitoron aktivizimin e çdo pedagogu në platformën interaktive UET LMS (Learning Management System) për lëndët dhe grupet përkatëse, si dhe në Microsoft TEAMS, në kuadër të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe të shërbimit ndaj studentëve.</p> <p>Në fund të çdo semestri, personi përgjegjës për menaxhimin e platformës UET LMS harton dhe dërgon Raportin mbi zhvillimin e mësimit online dhe aktivitetin e pedagogut në platforma, duke mundësuar raportime individuale dhe akses në të dhëna në kohë reale për drejtuesit dhe titullarët.</p> <p><i>E.46.5 Raport: Ecuria e mësimit online</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Faqja zyrtare e UET, në gjuhën shqipe dhe angleze, ofron informacion të plotë mbi programet e studimit të institucioni, të dhënat për personelin akademik sipas fakulteteve dhe departamenteve përkatëse, kualifikimet dhe CV-të e stafit akademik, si dhe aktivitetet kërkimore shkencore, leksionet e hapura dhe me personalitete të ftuar, projektet dhe njoftimet përkatëse.</p> <p><i>E. 47 Faqja zyrtare e UET www.uet.edu.al</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Sistemi i institucionit për menaxhimin e të dhënave të studentëve dhe të procesit mësimor është i strukturuar dhe siguron siguri dhe konfidencialitet përmes platformave UMIS, UET LMS dhe Microsoft Teams. Komunikimi akademik dhe monitorimi i aktivitetit të pedagogëve realizohen në mënyrë efektive. Studentët marrin informacion në kohë reale për</i></p>

	<i>programet dhe detyrat e tyre, duke përmbushur standardet e kërkuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Burimet financiare dhe menaxhimi i tyre përbëjnë element kyç për funksionimin e procesit mësimor.</p> <p>Institucioni harton çdo muaj raport të detajuar mbi të ardhurat dhe shpenzimet, duke u bazuar në buxhetin e miratuar dhe duke identifikuar fondet rezervë për shpenzimet me prioritet. Tarifat e shkollimit, kontributi nga grantet kërkimore, projektet e ndryshme dhe mbështetja e donatorëve të huaj përbëjnë burimet kryesore të financimit të UET. Shpenzimet e buxhetit përfshijnë pagesat për personelin akademik, mbështetjen e studentëve dhe mirëmbajtjen e mjediseve të institucionit.</p> <p>Raporti vjetor i auditimit përfshin gjithashtu analizën e kostove për çdo program, ndërsa të dhënat financiare përdoren për të përcaktuar strategjitë institucionale me qëllim përmirësimin e performancës dhe të cilësisë së mësimdhënies.</p> <p><i>E. 49 Të dhëna mbi koston për student</i> <i>E. 50. Të ardhura financiare dhe të ndryshme</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e</p>	<p>Institucioni harton planin e financimit të programit të studimit në përputhje me standardet e hartimit dhe raportimit financiar. Plani përfshin financimin e burimeve njerëzore të dedikuara për realizimin e programit.</p> <p>Plani mbulon shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe të teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, si dhe shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës. Plani siguron aksesin në bibliotekat online, mbulon detyrimet financiare, grantet vendase dhe të huaja të përfituara, kontratat e shërbimeve të lidhura me realizimin e programit mësimor dhe përfshin zëra të tjerë të përshtatur sipas specifikave të programit.</p>

<p>literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p><i>E. 50. Të ardhura financiare dhe të ndryshme</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Auditimi i brendshëm i Universitetit Europian të Tiranës kryhet çdo vit nga njësitë përkatëse të institucionit. Auditimi i jashtëm realizohet nga auditues të emëruar nga Ministria e Arsimit. Shoqëria E.E.I. Sh.p.k., e licencuar për ekspertizë financiare, harton çdo vit raport mbi transparencën e financave të institucionit.</p> <p>Audituesi i pavarur ligjor ofron opinion mbi gjendjen financiare dhe përputhshmërinë me standardet kontabël.</p> <p>Pasqyrat financiare paraqiten sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit dhe tregojnë saktë gjendjen financiare dhe performancën vjetore të institucionit. Auditimi i jashtëm, i zhvilluar pas mbylljes së pasqyrave, bazohet në analizën e të dhënave financiare dhe përfundon me raport që kontribuon në përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit.</p> <p><i>E. 50.1 Pasqyrat financiare</i> <i>E. 2. Statuti UET</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Institucioni paraqet gjendjen financiare për programin e studimit çdo fillim viti pranë njësisë përgjegjëse.</p> <p><i>E. 2. Statuti UET</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës</p>	<p>Në muajin tetor të çdo viti, institucioni harton buxhetin financiar. Nga aksionerët e institucionit miratohet buxheti. Për zbatimin e tij janë përgjegjës Administratori dhe Zyra e Financës. Ekuilibri mujor ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve sigurohet nga projekt-buxheti.</p> <p>Gjatë zhvillimit të programit të studimit, institucioni garanton qëndrueshmëri financiare dhe disponon kapacitete për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave. Vendime menaxheriale për stabilitetin dhe vazhdimësinë e programeve të studimit mundësohen nga</p>

financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	<p>analizat e efikasitetit dhe kostove, së bashku me auditimet e brendshme dhe të jashtme.</p> <p><i>E.50. 1 Pasqyrat financiare 2019</i> <i>E.50. 2 Pasqyrat financiare 2020</i> <i>E.50. 3 Pasqyrat financiare 2021</i> <i>E.50. 4 Raporti i auditimit 2018</i> <i>E.50. 5 Raporti i auditimit 2019</i> <i>E.50. 6 Raporti i auditimit 2020</i> <i>E. 2. Statuti UET</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Institucioni siguron menaxhim dhe financim të qëndrueshëm të burimeve financiare për të garantuar cilësinë e procesit mësimor. Buxhetet vjetore përgatiten nga institucioni dhe miratohen, ndërsa të ardhurat dhe shpenzimet monitorohen me rigorozitet. Financimi mbështetet kryesisht nga tarifat e studentëve, grantet dhe donatorët.</i></p> <p><i>Pasqyrat financiare hartohen sipas standardeve kombëtare dhe auditohen brenda dhe jashtë. Plani financiar për secilin program siguron transparencë dhe qëndrueshmëri në përdorimin e burimeve njerëzore, infrastrukturës dhe teknologjisë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të	Politikat dhe procedurat e gjera për programin Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu” janë krijuar dhe vënë në zbatim nga institucioni për ciklin e

<p>studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>dytë të studimeve universitare, duke garantuar respektimin e ligjeve përkatëse. Këto politika përshkruhen në Statut dhe Rregulloren përkatëse të Studimeve Universitare.</p> <p>Gjatë dy viteve akademike, 120 kreditet e programit janë të shpërndara për t'u siguruar studentëve njohuri të gjithanshme profesionale në fushën e komunikimit. Shqipja është gjuha e programit. Në faqen zyrtare të institucionit, në broshurën UET Guide, në mediat informative dhe gjatë seancave të këshillimit publikohen kërkesat e pranimit dhe procedurat e aplikimit, për të garantuar transparencë dhe akses të përshtatshëm në informacion.</p> <p>Progresi i studentëve monitorohet nga afër gjatë gjithë procesit arsimor nga institucioni, duke zbatuar politika dhe procedura të përcaktuara për mbështetjen e zhvillimit akademik dhe profesional.</p> <p><i>E. 5. Rregullore UET</i> <i>Faqja zyrtare e UET www.uet.edu.al</i> <i>E. 2. Statuti UET</i> <i>E. 28. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin</i> <i>E. 27.2. Mbi tutoriatin e këshillimit akademik</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Barazi e plotë dhe të njëjtat përfitime garantojnë për të gjithë kandidatët dhe studentët e regjistruar në programin Master i Shkencave në: “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu” që nga momenti i pranimit deri në diplomim.</p> <p><i>E. 5. Rregullore UET</i> <i>E. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor në “Shkenca Komunikimi”.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Në programet e studimit që ofron UET-i lejohen të regjistrohen shtetasit shqiptarë ose të huaj që plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga organet drejtuese të institucionit, në bashkëpunim me mekanizmat për kryerjen e maturës shtetërore, në përputhje me rregulloret e programit dhe ligjet në fuqi. Kërkesa shtesë për pranimin mund të vendosen nga departamenti për të zgjedhur aplikantët; këto bëhen të ditura në UET dhe i raportohen ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore. Parimet, kërkesat dhe hapat specifikë për pranimin e studentëve përcaktohen në një dokument të veçantë, të postuar në faqen zyrtare të UET-it.</p>

	<i>E. 5. Rregullore UET</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Informacioni i plotë dhe i përditësuar mbi programin e studimit Master i Shkencave në: “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu”, përfshirë kriteret pranimit, mundësi bursash dhe procedurat e aplikimit, gjendet në faqen zyrtare të universitetit përkatës dhe është i aksesueshëm për studentët. Studentët mund të konsultojnë gjithashtu informacion të detajuar mbi kriteret e pranimit, procedurat e përzgjedhjes, përparimin gjatë studimeve, mundësitë e transferimit të krediteve, njohjen e studimeve të mëparshme, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin. <i>Faqja zyrtare e UET www.uet.edu.al</i> <i>E. 5. Rregullore UET</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Informacioni i qartë dhe i detajuar mbi programet e studimit, përfshirë Masterin e Shkencave në: “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu” ofrohet nga Universiteti Europian i Tiranës (UET) për maturantët dhe të interesuarit. Ky informacion është i disponueshëm përmes kanaleve të ndryshme komunikimi, si faqja zyrtare e internetit, mbështetja nga këshilluesit e karrierës, zyra e pranimeve, takime të drejtpërdrejta me studentë potencialë dhe aktivitete si “Gjimnaz Tour”. Në këto aktivitete, maturantët njihen nga afër me programet akademike, kushtet e pranimit dhe shërbimet për studentët, gjë që i ndihmon ata të bëjnë zgjedhje të informuara dhe të ndërgjegjshme për të ardhmen e tyre akademike. <i>E. 12. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit</i> <i>E. 28. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin</i> <i>E. 27.2. Mbi tutoriatin e këshillimit akademik</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të	Përveç kriterëve të përcaktuara nga legjislativi, institucioni nuk vendos kërkesa shtesë për pranimin në programin Master i Shkencave në: “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu”. Politikat, kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve janë të pasqyruara në Dokumentin D.I. Çdo vit akademik, institucioni përcakton kuota të veçanta për përzgjedhjen e

pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	<p>kandidatëve me aftësi të kufizuara, si dhe për ata që i përkasin pakicave apo shtresave të marginalizuara.</p> <p><i>E. Dokumenti D.1. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.</i></p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Transferimet e studentëve në vitet ndërmjetëse pranohen nga UET-i nga universitete të tjera, qofshin ato vendase ose të huaja, publike ose jopublike. Ndërkohë, UET-i lejon edhe transferimin e studentëve të tij në institucione të tjera, sipas procedurave të miratuara me dokument të veçantë. Studenti duhet të ndjekë së paku një vit akademik në UET dhe të fitojë të paktën 25% të ECTS-ve për lëndët e kategorive A-D, duke përmbushur gjithashtu detyrimet përfundimtare të programit të studimit.</p> <p><i>E. 5. Rregullore UET</i></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Bursa të plota ose të pjesshme për studim ofrohen nga UET-i, duke u bazuar në kriteret të caktuara përzgjedhjeje, me qëllim nxitjen e rezultateve të larta akademike dhe mbështetjen sociale të grupeve të diskriminuara ose në nevojë. Zbritje në tarifën e shkollimit ofrohen gjithashtu për aplikantët ose studentët me rezultate të shkëlqyera, për ata që i përkasin të njëjtës familje, dhe politika ndihmëse/bursash zbatohet për individët në nevojë. Këto masa kontribuojnë në rritjen e cilësisë së pranimit në programet prioritare të institucionit dhe mbështesin zhvillimin ekonomik të vendit.</p> <p><i>E. 5. Rregullore UET</i> <i>E. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor në "Shkenca Komunikimi".</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Grupi i vlerësimit të jashtëm vlerëson se standardi përmbushet plotësisht. UET-ja garanton akses të barabartë për kandidatët dhe informacion të qartë mbi pranimin, bursat dhe përparimin akademik.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.2


Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Nëpërmjet zyrës së pranimeve, zyrës së këshillimit për karrierën dhe sekretarisë, institucioni vendos në dispozicion informacion të plotë dhe të detajuar mbi kriteret dhe procedurat për përparimin akademik të studentëve, si dhe për mundësinë e shtyrjes së vitit akademik në një periudhë tjetër.</p> <p><i>E. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor ne "Shkenca Komunikimi".</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Studentët informohen nga institucioni mbi kriteret dhe procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose të studimeve të pjesshme.</p> <p>Procedura e transferimit, që përfshin dorëzimin e kërkesës me shkrim nga studenti, njohjen e lëndëve dhe regjistrimin në programin e studimit, është e përcaktuar në Dokumentin D.II "Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin".</p> <p><i>E. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor ne "Shkenca Komunikimi".</i></p> <p><i>E. 5. Rregullore UET</i></p> <p><i>E. 28 Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Mënyra e vlerësimit të dijeve në lëndët përkatëse përcaktohet qartë në rregulloren e programit të studimit, duke u bazuar në tipologjinë e lëndëve.</p> <p>Studenti merr gjithashtu këtë informacion nga syllabusi i lëndëve. Si përfundim, konstatohet se institucioni siguron informacion të plotë mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve në programin e studimit.</p> <p><i>E. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor ne "Shkenca Komunikimi".</i></p> <p><i>E. 19 Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin Master Shkencoe ne "Shkenca të Komunikimit"</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Plani i diplomimit përcaktohet në mënyrë të detajuar në dokumentin për punimin e diplomës, duke përfshirë aplikimin për temë, miratimin e saj, zgjedhjen e pedagogut udhëheqës, procesin e shkrimit të tezës, kalendarin e seancave metodologjike, si dhe formatimin, dorëzimin dhe mbrojtjen e punimit. Fazat kohore për dorëzimin dhe mbrojtjen e diplomës bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik, ndërsa studentët njoftohen gjithashtu nga koordinatorët e Departamenteve përmes emailit për çdo veprimtari akademike.</p>

	<p><i>E. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor në "Shkenca Komunikimi".</i></p> <p><i>E. 10. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit</i></p> <p><i>E. 10.5. Kalendari akademik</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Institucioni informon të interesuarit mbi programin e studimit para fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike. Studentët e ardhshëm kanë mundësinë të njohin nga afër ambientet, pedagogët dhe procesin e mësimdhënies gjatë Ditëve të Hapura, të organizuara për çdo fakultet.</p> <p><i>E. 5. Rregullore e UET</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Informacion i qartë dhe i aksesueshëm mbi përparimin akademik, njohjen e krediteve, transferimet dhe vlerësimin e dijeve sigurohet nga institucioni për studentët, duke garantuar transparencë përmes dokumenteve zyrtare dhe komunikimit institucional. Procesi i diplomimit është i strukturuar mirë dhe shoqërohet me aktivitete promovuese për orientimin e studentëve të rinj, ndërsa mbështetja e vazhdueshme ofrohet gjatë gjithë ciklit studimor të programit Master i Shkencave në: "Shkenca Komunikimi" me profile "Marrëdhënie Publike Politike", "Menaxhim Marketingu".</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.3</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Informacion i detajuar mbi strukturën dhe kohëzgjatjen e programit Master i Shkencave në: "Shkenca Komunikimi" me profile "Marrëdhënie Publike Politike", "Menaxhim Marketingu" jepet në rregulloren përkatëse të programit, e cila publikohet në fillim të çdo viti akademik. Që nga momenti i aplikimit dhe regjistrimit, si dhe gjatë zhvillimit të programit, studentët informohen në mënyrë të hollësishme për</p>

	<p>strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit nga Zyra e Pranimeve, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe pedagogët. Ky informacion është gjithashtu i aksesueshëm përmes platformës UET LMS, ku çdo student mund ta konsultojë.</p> <p><i>E. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor ne "Shkenca Komunikimi".</i></p> <p><i>E. 12. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Grupet e pedagogëve të UET vizitojnë shkolla të mesme në qytete të ndryshme të vendit (Gjimnaz Tour), duke i prezantuar maturantëve programet e studimit, kushtet dhe shërbimet që ofrohen për studentët, në mënyrë që ata të marrin vendime të informuara dhe të ndërgjegjshme.</p> <p>Maturantët mund të ndjekin gjithashtu "Open Days", ku vizitojnë institucionin dhe marrin pjesë në orë të caktuara mësimi, ndërsa studentët e rinj orientohen gjatë Javës së Orientimit përpara fillimit të vitit akademik.</p> <p>Tutoriatu u ofrohet studentëve të ciklit të parë për të mbështetur identifikimin dhe arritjen e qëllimeve akademike, ndërsa këshillimi akademik ndihmon në zgjidhjen e çdo vështirësie që mund të lindë gjatë përmbushjes së detyrimeve të lëndëve. Informacioni dhe dokumentacioni mbi përmbajtjen dhe veprimtarinë formuese të lëndëve dhe moduleve janë të disponueshme për studentët në zyrën e sekretarisë dhe koordinatorëve, në UET LMS dhe në faqen zyrtare të institucionit. Në fillim të çdo semestri, syllabuset e lëndëve u jepen studentëve në formë të shkruar dhe elektronike.</p> <p><i>E. 10. Rregullore e UET</i></p> <p><i>E. 27.2. Mbi tutoriatin e këshillimit akademik</i></p> <p><i>E. 46.1 UET LMS Guidë për studentët.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni ofron mbështetje të vazhdueshme për studentët në lidhje me karrierën e tyre, duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Trajnime për hartimin e CV-së, letrës së motivimit dhe korrespondencës me zyrat e Burimeve Njerëzore të kompanive/organizatave, përfshirë edhe letrat e falenderimit dhe ato të refuzimit të pozicioneve. b) Këshillim për fazat e intervistës së punës dhe përgatitjen për të.



	<p>c) Prezantimin e kalendarit të eventeve të lidhura me industrinë, përfshirë Open Days për çdo fakultet dhe panairot e punës.</p> <p>d) Zhvillimin e sondazheve të planit të karrierës së studentëve, për të kuptuar burimet e punësimit, mundësitë e internship-eve dhe planet e karrierës.</p> <p>e) Mentorim dhe ndërtim rrjeti (networking) përmes gjithë burimeve dhe partneriteteve të universitetit, përfshirë Alumni, bordet e tregut të punës, grupet e studentëve në LinkedIn, si dhe rrjetin e studentëve që kanë kryer internship ose Erasmus.</p> <p>Në këtë mënyrë, studentët përfitojnë një orientim të plotë akademik dhe profesional, duke u përgatitur për tregun e punës dhe zhvillimin e karrierës.</p> <p><i>E. 12. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët marrin informacion të plotë dhe të qartë mbi zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet që mbështesin realizimin e tij. Sekretaria, koordinatorët, Zyrat e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentëve, si dhe platforma online UET LMS, sigurojnë akses në materialet e programit dhe mundësinë e shkëmbimit të informacionit me pedagogët dhe studentët e tjerë. Procesi i tutoratit dhe këshillimit akademik, i shpallur që në fillim të vitit akademik, përfshin seanca të dedikuara për të ndihmuar studentët në zgjedhjen dhe përmbushjen e detyrimeve të programit të studimit, monitorimin e përmbushjes së krediteve për kalimin në vitin pasardhës dhe motivimin për të arritur rezultate të larta akademike.</p> <p><i>E. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor në "Shkenca Komunikimi".</i></p> <p><i>E. 27.2 Mbi tutoriatin e këshillimit akademik</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Informacioni mbi procesin mësimor është i aksesueshëm lehtësisht përmes faqes së internetit të Fakultetit dhe platformës UET LMS. Secili student disponon një llogari personale në LMS, e cila i mundëson të marrë shërbime të ndryshme dhe të ketë qasje në informacionin e nevojshëm edhe në distancë. Ky sistem siguron pavarësi, lehtësi në përdorim dhe rrit transparencën në marrjen e shërbimeve akademike.</p>

	<i>E. 46.1 UET LMS Guidë për studentët.</i>			
Konkluzione	<i>Grupi i ekspertëve vlerëson se program i studimit Master i Shkencave në: “Shkenca Komunikimi” me profile “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu” ofrohet dhe zbatohet në mënyrë transparente, duke i siguruar studentëve qasje të lehtë dhe të qartë në informacion. Mbështetja për studentët, përmes aktiviteteve promovuese, tutorimit, këshillimit akademik dhe ndihmës për karrierën, tregon një angazhim të plotë për sigurimin e cilësisë dhe përputhshmërisë me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	Institucioni mbledh dhe mban statistika vjetore mbi studentët e diplomuar në programin Master i Shkencave në: “Shkenca Komunikimi” me profile “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu”. Përmes Zyrës së Zhvillimit të Karrierës dhe Shoqatës Alumni, institucioni ruan kontakte të vazhdueshme me ish-studentët, jo vetëm për të ndarë eksperiencat dhe arritjet e tyre profesionale, por edhe për të krijuar lidhje efektive midis universitetit dhe tregut të punës. <i>E. 29 Të dhëna përmbledhëse për punësimin real të studentëve</i> <i>E. 27.1 Cilësia në hyrje dhe në dalje të studentëve.</i> <i>E. 55.3 Kalendarit i aktiviteteve të planifikuara të Departamentit të Shkencave Humane dhe Komunikimit.</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe	Institucioni mbledh dhe ruan statistika vjetore mbi studentët e regjistruar në programin e studimit Master i Shkencave në: “Shkenca Komunikimi” me profile, duke përfshirë tërheqjet nga programi, largimet para përfundimit të tij, si dhe rastet e mospërfundimit me sukses të vitit akademik përkatës. Për tri vite akademike program i studimit Master i Shkencave në:

<p>largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>“Shkenca Komunikimi” me profile a) “Marrëdhënie Publike Politike” b) “Menaxhim Marketingu”.</p> <table border="1" data-bbox="611 275 1378 488"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>“Marrëdhënie Publike Politike”</th> <th>“Menaxhim Marketingu”</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2022-2023</td> <td>15 studentë</td> <td>12 studentë</td> </tr> <tr> <td>2023-2024</td> <td>12 studentë</td> <td>11 studentë</td> </tr> <tr> <td>2024-2025</td> <td>13 studentë</td> <td>9 studentë</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>E. 27.1 Cilësia në hyrje dhe në dalje të studentëve</i></p>	Viti akademik	“Marrëdhënie Publike Politike”	“Menaxhim Marketingu”	2022-2023	15 studentë	12 studentë	2023-2024	12 studentë	11 studentë	2024-2025	13 studentë	9 studentë
Viti akademik	“Marrëdhënie Publike Politike”	“Menaxhim Marketingu”											
2022-2023	15 studentë	12 studentë											
2023-2024	12 studentë	11 studentë											
2024-2025	13 studentë	9 studentë											
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat statistike të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm UMIS, ku ruajtja dhe verifikimi kryhen në mënyrë të sigurt nga personat e autorizuar, si stafi IT dhe sekretaria mësimore. Për mbështetje shtesë, përdoret edhe sistemi UET LMS.</p> <p><i>E. 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.</i> <i>E. 9. Mbi funksionimin e sekretarisw mwsimore.</i></p>												
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Çdo student ka një dosje personale që përmban të gjitha të dhënat, nga momenti i regjistrimit deri pas diplomimit. Këto informacione ruhen në Sekretarinë Mësimore dhe në Zyrën e Regjistrimit të Studentëve. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit (UMIS) administron dhe përpunon të gjitha të dhënat akademike të studentëve, si dhe prodhon raportet statistikore të nevojshme.</p> <p><i>E. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor ne “Shkenca Komunikimi”.</i></p>												
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me</p>	<p>Në UET përgatiten raporte analitike periodike që pasqyrojnë profilin dhe cilësinë e studentëve në momentin e hyrjes dhe të daljes, si dhe nivelin e punësimit të tyre. Të dhënat e mbledhura përdoren për të marrë masa të duhura që synojnë përmirësimin e këtyre treguesve.</p> <p><i>E. 27.1 Cilësia në hyrje dhe në dalje të studentëve</i></p>												



masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<i>E. 38. Analiza e departamentit mbi arritjen e objektivave formuese të MSHSHK</i> <i>E. 29. Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve</i>			
Konkluzione	<i>Gjatë gjithë ciklit studimor, institucioni mbledh dhe menaxhon të dhënat statistikore të studentëve përmes platformave UMIS dhe UET LMS. Për të monitoruar dhe përmirësuar vazhdimisht cilësinë e programit, përdoren raportet analitike periodike mbi hyrjen, daljen dhe punësimin e studentëve, ndërsa lidhja me ish-studentët realizohet aktivisht përmes Zyrës së Zhvillimit të Karrierës dhe Shoqatës Alumni, si dhe raportet analitike periodike mbi hyrjen, daljen dhe punësimin, tregojnë një angazhim proaktiv për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Sipas Rregullores së UET, studenti përfshihet në mënyrë të qartë në strukturat vendimmarrëse dhe këshilluese të institucionit. Përfshirja dhe angazhimi i tyre realizohet përmes Këshillit Studentor, fokus-grupeve të vlerësimit të lëndëve dhe pedagogëve, si dhe vlerësimeve online të pedagogut. Për më tepër, studentët marrin pjesë në Senatin Akademik të UET, Dekanat, Këshillin e Etikës dhe Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, sipas rregullave ligjore dhe rregullatore të universitetit. <i>E. 5. Rregullore e UET</i> <i>E. 12. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi	Institucioni siguron që studentët të jenë të përfshirë në vendimmarrje dhe aktivitete të matshme e të verifikueshme, përfshirë pjesëmarrjen në Këshillin e Studentëve, këshillimin dhe vlerësimin e procesit akademik, si dhe vlerësimin e pedagogëve që japin mësim. Të dhënat mbi këtë përfshirje



<p>procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>administrohen dhe ruhen nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.</p> <p><i>E. 5. Rregullore e UET</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Studentët përfshihen në mënyrë aktive në hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, duke marrë pjesë periodikisht në mbledhjet e hapura të departamentit dhe në fokus grupet e ndryshme, ku mund të japin sugjerime. Përveç kësaj, ata kanë mundësinë të japin mendimet e tyre online në çdo kohë përmes UET LMS dhe Microsoft TEAMS, duke komunikuar drejtpërdrejt me departamentin përkatës.</p> <p><i>E. 6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe të Departamentit</i></p> <p><i>E. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor ne "Shkenca Komunikimi".</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentëve u sigurohet mundësia për të dhënë mendimet e tyre mbi barazinë dhe drejtësinë e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve; pedagogu përgjegjës mund të ofrojë rishikim dhe diskutim mbi rezultatet, përfshirë edhe mundësinë e ankimit. Provimet kryhen në mënyrë të sekretuar, duke garantuar anonimitetin e plotë të studentit. Transparente janë gjithashtu vlerësimet e rubrikave të tjera, dhe pas çdo provimi organizohen seanca sqaruese ku studentët komunikojnë me pedagogun përkatës për rezultatet dhe opsionin e rishikimit. Kur ndodh ankimi, një komision AD-HOC i ngritur në nivel Departamenti ose Fakulteti përcakton vlerësimin, duke respektuar plotësisht procedurat transparente.</p> <p><i>E. 7. Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor ne "Shkenca Komunikimi".</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Grupi i vlerësimit të jashtëm evidenton se Universiteti European i Tiranës ka vendosur mekanizma dhe politika efektive që garantojnë përfshirjen e studentëve në vendimmarrje dhe proceset akademike në mënyrë aktive dhe të matshme, përfshirë pjesëmarrjen në Këshillin Studentor, Senatit Akademik dhe komisionet e ndryshme. Sistemi i vlerësimit akademik, duke respektuar anonimitetin dhe të drejtat e studentëve, funksionon në mënyrë transparente, ndërsa mundësitë për ankim dhe rishikim forcojnë</i></p>

	<i>bashkëpunimin dhe dialogun midis studentëve dhe stafit akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p>Për studentët e programit, UET ka vendosur njësi dhe procedura të specializuara që sigurojnë shërbim dhe informim në përputhje me ligjet dhe aktet rregullatore të IAL-ve. Informacioni dhe dokumentacioni i detajuar mbi lëndët/modulet, përmbajtjen, aktivitetet formuese dhe gjithë procesin akademik është i aksesueshëm në zyrën e sekretarisë, te koordinatorët, në UET LMS dhe në faqen zyrtare të institucionit. Javën e orientimit akademik, që organizohet në fillim të çdo semestri, studentët marrin syllabuset dhe informacionet e tjera të nevojshme në formë të shkruar dhe elektronike. Një rol të veçantë në këtë proces ka Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.</p> <p><i>E. 12. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit</i> <i>E. 46.2. Guidë për studentët.</i></p>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<p>Për studentët, UET ka vendosur një sistem të posaçëm informimi, këshillimi, ndjekjeje dhe asistence përmes Zyrës së Pranimeve. Mbështetja e studentëve për çështje që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit sigurohet edhe nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, Zyra e Projekteve dhe Partneriteteve, këshilluesit akademikë, sekretaria mësimore, koordinatorët e departamenteve dhe regjistruarit e lëndëve. Informacioni dhe asistenca ofrohen kryesisht përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe njësive të tjera, si dhe në platformat UET LMS dhe Microsoft TEAMS, ku studentët mund të marrin të dhëna të përditësuara mbi procesin mësimor dhe programin e studimit. Përveç kësaj, informimi realizohet edhe përmes emailit dhe publikimeve pranë këndit të njoftimeve, duke</p>

	<p>garantuar qasje të vazhdueshme dhe këshillim nga individët dhe njësitë përgjegjëse.</p> <p><i>E. 9. Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit ofron vazhdimisht orientim dhe informacion të detajuar për studentët, duke përfshirë këshillimin për karrierën, udhëzime mbi kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera, si dhe informacion mbi mundësitë dhe kërkesat e tregut të punës.</p> <p><i>E. 27.2 Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik</i></p> <p><i>E. 12. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, së bashku me Shoqatën Alumni, ndjek pas diplomimit studentët e programit të studimit, duke mbledhur, përpunuar dhe ruajtur të dhëna mbi punësimin e tyre. Këto të dhëna vihen në dispozicion të studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse. Për më tepër, zyra ndërmerr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit përmes bashkëpunimit me organizatat partnere të UET, dhe feedback-u mbi këto aktivitete i komunikohet veçmas studentëve dhe organeve drejtuese të universitetit.</p> <p><i>E. 29. Tabelë përmbledhëse për punësimin real të studentëve.</i></p> <p><i>E. 12. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentëve.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Njësitë e specializuara dhe platformat elektronike, përfshirë UET LMS dhe Microsoft Teams, përdoren nga Universiteti European i Tiranës për të ofruar mbështetje dhe informim të vazhdueshëm për studentët gjatë gjithë ciklit akademik. Pas diplomimit, institucioni monitoron punësimin e studentëve në bashkëpunim me Shoqatën Alumni dhe partnerë të ndryshëm, duke përmirësuar lidhjet me tregun e punës dhe cilësinë e shërbimeve.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Si prioritet thelbësor, institucioni ka vendosur trajnimin e personelit akademik për ndryshimin e stilit dhe metodave të mësimdhënies, duke e konsideruar këtë një investim dhe domosdoshmëri për zhvillimin e burimeve njerëzore. Krahas trajnimit, angazhimi i stafit akademik në punë të thelluar kërkimore dhe pedagogjike parashikohet si alternativë për pasurimin dhe zhvillimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, çka i mundëson ndjekjen e zhvillimeve të fundit në fushën përkatëse. Sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit, në bashkëpunim me Zyrën e Burimeve Njerëzore, realizon identifikimin e nevojave për kualifikime përditësuese. Për më tepër, institucioni ka krijuar një sistem për menaxhimin e performancës së personelit akademik, i cili thjeshtëson identifikimin e atyre që përdorin metoda të vjetra mësimdhënieje dhe që kanë nevojë për kualifikime përditësuese. Vlerësimi përmes follow-up, fokus-grupesh, orëve mësimore dhe raportimit mbi përdorimin e platformës LMS për mësimdhënien përfshihet gjithashtu në këtë sistem.</p> <p><i>E. 3.2. Strategjia e kërkimit shkencor UET 2021-2025</i> <i>E. 33. Të dhëna për trajnime profesionale për stafin</i> <i>E. 41 Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik</i> <i>E. 37 Formimi i relacionit për monitorimin e silabuseve</i></p>

<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Periodikisht, personeli akademik dhe ndihmës-akademik në institucion nënshtrohet trajnimeve, testeve dhe vlerësimeve nga strukturat përgjegjëse, me qëllim vlerësimin dhe identifikimin e aftësive inovative dhe mësimdhënëse. Në këtë mënyrë nxitet dëshira dhe prirja e personelit për të sjellë risitë dhe përparimin në përcjelljen e dijes tek studentët.</p> <p>Mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në auditor, vlerësimi i mësimdhënësit kryhet kryesisht për anëtarët e personelit akademik të kategorive “Lektor” dhe “Asistent-lektor”, nga Dekanati, përgjegjësi i Departamentit ose përgjegjësi i grup lëndësh. - Nga studentët, vlerësimi i pedagogut dhe lëndës bëhet në fund të çdo semestri, duke ruajtur anonimat, përmes fokus-grupesh dhe opinionëve të shprehura në mbledhjet e hapura të departamentit. - Rezultatet e raporteve të përgatit KSBC, e cilat janë të drejtpërdrejta përgjegjëse për mbarrëvajtjen dhe cilësinë e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Aktivitetet kryhen periodikisht sipas planit të veprimit për sigurimin e cilësisë dhe metodologjisë përkatëse, dhe relacionet përkatëse dërgohen Rektoratit dhe/ose Departamenteve. - Nga Komisioni i Vlerësimit të Performancës, i ngritur nga Rektori, bëhet vlerësimi (follow-up). <p><i>E. 3.2. Strategjia e kërkimit shkencor UET 2021-2025</i> <i>E. 2 Statuti UET</i> <i>E. 5. Rregullore UET</i> <i>E. 33. Të dhëna për trajnime profesionale për stafin</i> <i>E. 30.13 Metodologjia e punës së KSBC</i> <i>E. 40 Formatit i vlerësimit të pedagogut nga studentët</i> <i>E. 30.5 Metodologjia e punës së aktivitetëve të KSBC</i> <i>E. 30.1 Plani i veprimit të KSBC</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Studentët përfshihen nga UET në vlerësimin periodik të cilësisë së mësimdhënies, duke pasur të drejtën për të vlerësuar pedagogun dhe cilësinë e orës së mësimin. Ky vlerësim realizohet përmes formularëve/pyetësorëve anonimë nga studentët, të organizuar dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet, ciklet, lëndët dhe pedagogët. Skedat e pyetësorëve përpunohet dhe i vihen në</p>


	<p>dispozicion drejtuesve të institucionit, si dhe secilit pedagog në mënyrë të personalizuar.</p> <p>Studentët gjithashtu kanë mundësinë për të trajtuar ankimime nëpërmjet mbledhjeve mujore të përbashkëta me stafin akademik, ku diskutohen problematikat e mundshme gjatë zhvillimit të procesit mësimor.</p> <p>Për vlerësimin individual të studentëve, brenda dy javëve nga data e zhvillimit të provimit zhvillohen seanca sqaruese, dhe vetëm në rast pakënaqësie pas këtyre seancave, studenti drejtohet te Përgjegjësi i Departamentit për rivlerësim, sipas nenit 32 të Rregullores së UET.</p> <p><i>E. 40 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët</i> <i>E. 5. Rregullore UET</i> <i>E. 40.1. Formular për ankesat e studentëve</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Në mënyrë periodike, në fund të çdo semestri, strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit të përfuturës. Një nga format e vlerësimit periodik të metodave të mësimdhënies dhe dijeve realizohet përmes vlerësimit të pedagogut nga studentët. Pas çdo monitorimi hartohet një raport individual dhe një raport i përgjithshëm për secilin pedagog, ku ai informohet mbi rezultatet e marra nga vlerësimi i studentëve. Departamenti analizon këto rezultate, verifikon besueshmërinë e tyre dhe merr masat e nevojshme për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e vlerësimit, pasi përpunohen nga KSBC ose nga zyra e IT në rastin e vlerësimeve online, komunikohen autoriteteve drejtuese të UET, si dhe anëtarëve të personelit akademik nga Përgjegjësi i Departamentit.</p> <p><i>E. 2 Statuti UET</i> <i>E. 40 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët</i> <i>E. 5. Rregullore UET</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të tij specifike, promovon shembuj praktikash të mira dhe frytdhënëse për monitorimin e vlerësimit dhe rezultateve të marra, të cilat inkurajojnë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. Në mbledhjet e departamentit, diskutohen të gjitha rezultatet e gjeneruara nga format e ndryshme të monitorimit lidhur me vlerësimin dhe përmirësimin e mësimdhënies, duke nxjerrë në pah shembuj pozitivë dhe duke nxitur avancimin e praktikave mësimore.</p>



	E. 5. Rregullore UET			
Konkluzione	<i>Në institucion funksionon një sistem i strukturuar për trajnimin, vlerësimin dhe monitorimin e personelit akademik, i cili siguron përmirësim të vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies dhe përfshirjen transparente të studentëve në procesin e vlerësimit. Rezultatet analizohen dhe diskutohen rregullisht në nivel departamenti, duke nxitur praktikat e mira dhe identifikuar masat e nevojshme për rritjen e cilësisë së mësimdhënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Institucioni ka ndërtuar politika, struktura dhe procedura të qarta për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me legjislacionin shqiptar, VKM-të përkatëse dhe Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë. Në planin strategjik të universitetit, sigurimi i cilësisë trajtohet si prioritet themelor për rritjen e reputacionit të institucionit brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Në përputhje me parimet e Procesit të Bolonjës dhe standardet evropiane për sigurimin e cilësisë, UET ka përcaktuar politika dhe procedura që mbulojnë monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, vlerësimin e studentëve, sigurinë e stafit akademik, burimet mësimore dhe shërbimet për studentët, si dhe sistemet informative.</p> <p>Strukturat institucionale për implementimin e SBC përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zyrën e Standardeve dhe Cilësisë (ZSC), përgjegjëse për koordinimin e sistemit; • Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel fakulteti dhe universiteti; • Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Zyrën e Kurrikulave; • Përfaqësues të studentëve dhe anëtarë të përzgjedhur nga Asambleja e Personelit Akademik në komisione.

	<p>Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë specifikon procedurat, proceset dhe mekanizmat për monitorimin dhe vlerësimin e programeve, mësimdhënies, mësimnxënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve ndaj studentëve. Kjo strukturë dhe sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë janë në përputhje me nenin 11 të Statutit të UET dhe sigurojnë funksionimin efektiv të mekanizmave institucionale të cilësisë.</p> <p><i>E. 3.3 Plani Strategjik 2021-2025</i> <i>E. 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë, 2023-2028</i> <i>E. 5 Rregullore e UET</i> <i>E. 30. 2. Manual i sigurimit të brendshëm të cilësisë</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>UET ka ngritur Komisionin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KSBC), i cili funksionon sipas Statutit të universitetit, Rregullores së institucionit, Strategjisë për Sigurimin e Cilësisë dhe Manualit për Sigurimin e Cilësisë. Studentët përfshihen aktivisht në këtë proces, duke qenë pjesë e KSBC, duke marrë pjesë në fokus-grupe, në vlerësime online përmes platformës UET LMS, dhe duke komunikuar në çdo moment me stafin e UET. Ata kanë gjithashtu mundësinë për të paraqitur ankime dhe sugjerime për procesin mësimor.</p> <p>Përfshirja e studentëve realizohet edhe përmes formularëve të posaçëm, të cilët i lejojnë ata të vlerësojnë qartësinë e shpjegimeve të pedagogut, interesin që ai nxit në lëndë dhe aftësinë për të stimulur mendimin kritik.</p> <p>Sipas pikës 5.4 të Strategjisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (Kreu V: Komisioni për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë), KSBC përbëhet nga: Kryetari i Komisionit, dy përfaqësues lektorë nga secili fakultet, një përfaqësues nga stafi administrativ, një përfaqësues i Këshillit Studentor dhe të paktën një ekspert i jashtëm.</p> <p>Në Strategjinë 2023-2028, pika 3.1 mbi “Organe, autoritet dhe struktura në nivel institucional” përcakton përgjegjësitë dhe kompetencat e KSBC, duke përfshirë bashkëpunimin me ekspertë të jashtëm. Përfshirja e këtyre ekspertëve është thelbësore për garantimin e objektivitetit dhe paanshmërisë, si dhe për të sjellë perspektiva të reja dhe përmirësime në praktikat e implementuara brenda institucionit.</p>



	E. 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë, 2023-2028
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në Arsimin e Lartë në UET realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm për akreditim, analizave krahasuese dhe raporteve të ndryshme, përfshirë ato të RVJ pranë KSBC, të cilat kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së programeve dhe funksionimit të institucionit.</p> <p>UET u hap për herë të parë me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 636, datë 20.09.2006 dhe u akreditua për herë të parë me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 246, datë 24.07.2009. Gjatë vitit 2017, UET i është nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët e ASCAL për akreditim institucional dhe ka marrë vlerësim pozitiv, i shoqëruar me disa rekomandime nga Bordi i Akreditimit, konkretisht me Vendimin Nr. 12, datë 07.04.2017. Ky akreditim institucional kishte një afat prej 5 vitesh dhe përfundoi më 06.04.2022. Gjithashtu, UET ka marrë akreditim nga QAA, i cili mbetet i vlefshëm deri më 11 dhjetor 2027.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale i UET u riorganizua sipas Vendimit nr. 7, datë 14.06.2018 të Senatit Akademik të universitetit. Në kuadër të këtij riorganizimi, UET iu nënshtrua akreditimit institucional pas ristrukturimit të disa fakulteteve ekzistuese dhe hapjes së dy fakulteteve të reja, dhe vendimi i akreditimit u miratua me VBA nr. 46, datë 05.07.2019.</p> <p>Për të adresuar rekomandimet e marra, UET përfshiu në programin e masave veprime për përmirësimin e administrimit të viteve akademike dhe plotësimin e këtyre sugjerimeve. Në dhjetor 2022, institucioni mori vlerësim pozitiv për akreditimin institucional nga Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë (AAQ) për një periudhë 5-vjeçare.</p> <p><i>E. 54.1 VKM nr 636, datë 20.09.2006 "Për hapjen e UET"</i> <i>E. 54.3 UMAS nr. 246, datë 24.07.2006 "Për akreditimin institucional të UET"</i> <i>E. 54.2 Vendimi i Senatit të UET nr. 7 datë 14.06.2018 "Për miratimin e riorganizimit dhe përshtatjes së programeve të ciklit të parë dhe të dytë të studimit".</i> <i>E. 54.8.2 VBA Nr. 46, datë 05.07.2019 "Për akreditimin institucional të UET".</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>UET përdor metodologji dhe instrumente të ndryshme për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimit dhe aktiviteteve të tjera akademike. Aktivitetet me karakter monitorues dhe vlerësues, të organizuara nga KSBC, mbulojnë të gjitha proceset akademike gjatë vitit dhe rezultatet e tyre raportohet pranë Rektoratit dhe Dekanateve të fakulteteve përkatëse.</p> <p>Përveç kësaj, KSBC jep rekomandime dhe përcakton detyra, zbatimin e të cilave ndiqet nga strukturat drejtuese dhe nga vetë komisioni përgjegjës. Rezultatet e vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit përpilohen në formë dokumenti dhe bëhen të njohura për autoritetet përgjegjëse, si titullari i lëndës, përgjegjësit e grup-lëndëve, përgjegjësi të departamentit dhe strukturat e tjera drejtuese.</p> <p><i>E. 30.5 Metodologjia e punës së KSHC</i> <i>E. 37 Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UET ka krijuar dhe zbatuar një sistem të organizuar dhe funksional për sigurimin e brendshëm të cilësisë, duke respektuar legjislacionin në fuqi si dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë. Në këtë proces janë aktivisht të përfshirë studentët dhe ekspertët e jashtëm, ndërsa monitorimi dhe raportimi realizohen në mënyrë të rregullt dhe transparente. Kjo qasje dëshmon përkushtimin e institucionit ndaj përmirësimit të vazhdueshëm të programeve akademike.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënësve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë</p>	<p>Raportet periodike mbi shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit përgatiten dhe shpërndahen nga UET në formë dokumenti, i cili u vihet në dispozicion pedagogëve, strukturave drejtuese dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Këto vlerësime diskutohen dhe prezantohen si në nivel Rektorati, ashtu edhe në nivel departamenti.</p>

<p>akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p><i>E. 30.6 Format raporti për provimet</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Raportet e vlerësimit përfshijnë rezultatet e pritshme, konkluzionet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë. Në lidhje me kontrollet e zhvillimit të provimeve, qofshin ato përfundimtare apo të ndërmjetme, seksioni i parë i raportit evidenton gjetjet dhe problematikat, duke përfshirë lëndën dhe pedagogun përkatës, ndërsa seksioni i dytë ofron një analizë më të detajuar të këtyre çështjeve. Ky komponent siguron dokumentimin e rezultateve të vlerësimit, ndërsa përshkrimi i metodologjisë së punës së KSBC tregon rezultatet e pritshme duke u bazuar në kriteret e vlerësimit të përcaktuara.</p> <p>Analizat vjetore në nivel departamenti sqarojnë më tej masat e marra dhe mënyrën se si janë adresuar mangësitë e identifikuara, duke kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Raportet e vlerësimit gjithashtu dokumentojnë përputhshmërinë e aktiviteteve me aktet rregullatore dhe standardet e cilësisë. KSBC dhe strukturat e tjera të përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë monitorojnë zbatimin e masave të ndërmarra për të adresuar mangësitë e konstatuara, me qëllim forcimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e</p>	<p>Cilësia e programit të studimit vlerësohet në UET përmes metodave të drejtpërdrejta, duke përfshirë elemente si</p>

<p>cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>mësimdhënia, didaktika, kurrikula, provimet dhe detyrat e studentëve.</p> <p>Për vlerësimin e cilësisë së programeve, UET përdor analiza të treguesve të matshëm, përfshirë notat mesatare në hyrje dhe dalje, kalueshmërinë sipas lëndëve/moduleve, vlerësimin e punës së pedagogëve gjatë semestrit, monitorimet e orëve të mësimdhënies, rishikime vjetore të syllabuseve, përfshirjen e praktikave ndërkombëtare më të mira, angazhimin e stafit akademik në projekte, si dhe analizën e infrastrukturës në shërbim të procesit mësimor.</p> <p>Veprimtaria monitoruese e KSBC është e strukturuar në katër fusha kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) <i>Mësimdhënia, mësimnxënia dhe vlerësimi</i> – monitorimi i orëve dhe procesit mësimor, marrja e opinionit të studentëve dhe përdorimi i sistemit LMS nga KSBC. b) <i>Kërkimi shkencor</i> – ngritja e grupeve AD-Hoc për kërkimin dhe metodologjinë e personelit akademik, krijimi i grupeve kërkimore dhe aktiviteti individual i stafit akademik. c) <i>Mbështetja e studentëve</i> – monitorimi i hyrjeve dhe daljeve të studentëve, lidhja e marrëveshjeve bashkëpunimi me institucione dhe subjekte, si dhe vlerësimi i punësimit të të diplomuarve. d) <i>Sigurimi i cilësisë</i> – trajnimi për standardet e akreditimit dhe sigurimit të cilësisë, rishikimi i rregulloreve dhe programeve, analiza SWOT, vlerësimi i burimeve njerëzore dhe ambientit, zhvillimi i testeve dhe detyrave, përgatitja e syllabuseve. <p>Si pjesë e procesit të vlerësimit të performancës, është implementuar edhe <i>Follow Up</i>, që monitoron mësimdhënien dhe aktivitetet kërkimore-shkencore të pedagogëve nga drejtuesit e institucionit.</p> <p><i>E. 52. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese. Procedura për ndryshimin e kurrikulës</i> <i>E. 30.8 Formulari i vlerësimit të pefagogut nga eprori-kolegu</i> <i>E. 30.1 Plani i veprimit KSBC</i> <i>E. 29. Tabelat përmbledhëse për punësim real të studentëve</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e</p>	<p>Për të vlerësuar mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit, institucioni përdor metoda dhe instrumente të tërthorta.</p>

<p>cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Në këtë kuadër, përfshihen fokus-grupet, pyetësorët online në UET LMS, si dhe mbledhjet e bordit me të diplomuarit (alumni), të cilat synojnë shkëmbimin e eksperiencave dhe përfshirjen e ish-studentëve në aktivitete me UET.</p> <p>Gjithashtu, për të vlerësuar dijet dhe kompetencat që transmeton programi, përdoren edhe aktivitete të tjera të rëndësishme, si Panairi i Përvitshëm i Punës, mbledhjet me personelin akademik dhe ndihmës-akademik, si dhe vizitat monitoruese nga drejtuesi i Departamentit dhe përgjegjësit e grup-lëndëve.</p> <p><i>E. 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë, 2023-2028</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Grupi i ekspertëve të jashtëm vlerëson se përgatitja dhe shpërndarja e raporteve periodike të vlerësimit dhe monitorimit të programeve të studimit në UET realizohet përmes një sistemi të mirëstrukturuar dhe funksional, i cili përfshin analiza të detajuara dhe masa për përmirësimin e cilësisë. KSBC ka një rol kyç në koordinimin dhe mbikëqyrjen e këtyre proceseve, ndërsa përdorimi i metodave të ndryshme të vlerësimit dhe përfshirja e komunitetit akademik dhe profesional kontribuojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të arsimit të ofruar.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe</p>	<p>Strukturat përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, të përbëra nga përfaqësues të hierarkisë institucionale dhe Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përcaktojnë politika dhe procedura të brendshme për përmirësimin e vazhdueshëm dhe sigurimin e cilësisë së programeve të studimit.</p>

<p>të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Vlerësimi i brendshëm i cilësisë realizohet në përputhje me objektivat strategjikë, vizionin dhe misionin e institucionit, si dhe kuadrin rregullator të UET. Parimet, detyrat dhe aktivitetet e sigurimit të cilësisë mbështeten në Statutin dhe Rregulloren e institucionit, Strategjinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, standardet europiane dhe ato kombëtare për sigurimin e cilësisë.</p> <p>Në këtë kuadër rregullator dhe udhëzues përcaktohen qartë funksionet, përgjegjësitë dhe organizimi i zyrave përbërëse, si dhe dokumentacioni i nevojshëm për procesin e vlerësimit të brendshëm. Studentët përfshihen aktivisht në këtë proces përmes strukturave vendimmarrëse dhe shprehjes së mendimeve të tyre, duke përdorur forma të ndryshme të vlerësimit, si pyetësorë dhe fokus-grupe.</p> <p><i>E. 30. 2. Manual i sigurimit të brendshëm të cilësisë</i> <i>E. 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë, 2023-2028</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit, UET përcakton detyra dhe përgjegjësi konkrete dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të tyre.</p> <p>Metodologjinë dhe praktikën e sigurimit të brendshëm të cilësisë, institucioni ka përmirësuar përmes pjesëmarrjes në trajnim, vizita studimore dhe workshop-e të organizuara brenda projekteve ndërkombëtare, duke siguruar zbatimin efektiv të detyrave të përcaktuara.</p> <p>Organizim dhe funksionimin e sistemit për sigurimin e brendshëm të cilësisë, Strategjia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë i përshkruan duke përfshirë parimet, qëllimet, objektivat, strukturat përbërëse, detyrat, përgjegjësitë, trajnimet, si dhe angazhimin e studentëve dhe palëve të tjera. Bashkëpunimi i Komisionit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KShC) me Fakultetin e Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, si dhe me Departamentin e Shkencave Humane dhe Komunikimit, realizohet përmes trajnimit të stafit, monitorimit të aktiviteteve për zbatimin dhe vlerësimin e syllabuseve, si dhe për plotësimin e planit mësimor dhe të punës kërkimore.</p>
	<p><i>E. 14.2 Plani mësimor i programit shqip</i> <i>E. 14.4 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtareve formuese</i></p>



	<i>E. 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë, 2023-2028</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	<p>Përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës-akademik e administrativ, si dhe studentëve të programit të studimit, garanton vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit.</p> <p>Departamenti dhe personeli akademik i programit të Master Shkencor në Shkenca Komunikimi me profile “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu” kontribuojnë vazhdimisht me analiza dhe sugjerime në procesin e vlerësimit të brendshëm dhe përditësohen rregullisht me informacionin përkatës.</p> <p><i>E. 30. 2. Manual i sigurimit të brendshëm të cilësisë</i> <i>E. 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë, 2023-2028</i></p>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	<p>Gjatë përfshirjes dhe aktivizimit të aktorëve të brendshëm në procesin e vlerësimit, institucioni garanton respektimin e integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve, në përputhje me Statutin dhe Rregulloren.</p> <p>Parimet e etikës akademike dhe publike, të detyrueshme për të gjithë, janë të përcaktuara në Kodin e Etikës së UET, duke u përputhur me misionin dhe vizionin e institucionit në mjediset universitare.</p> <p><i>E. 56. Kodi i Etikës.</i></p>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vëra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<p>Bashkëpunëtorët dhe ekspertët e jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit përfshihen aktivisht në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duke dhënë mendim dhe ekspertizë për cilësinë e programit dhe përmirësimin e tij.</p> <p>Aktivitete të tilla si Panairi i Punës, leksionet e hapura me personalitete të fushës, si dhe marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit me institucione arsimore publike dhe private, vendase dhe të huaja, me institucione të shoqërisë civile, biznese, partnerë dhe donatorë, janë kthyer në një traditë në jetën universitare të UET.</p> <p><i>E. 12.2 Poster Panairi i punës</i></p>
Konkluzione	<i>Për sigurimin e brendshëm të cilësisë, institucioni ka krijuar një sistem funksional dhe të qëndrueshëm, duke përfshirë</i>

	<i>politika, procedura dhe detyra të qarta për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve, në përputhje me kuadrin ligjor dhe standardet kombëtare e europiane. Aktivisht përfshihen studentët, stafi akademik dhe ekspertët e jashtëm, ndërsa angazhimi në trajnime dhe bashkëpunime ndërkombëtare siguron transparencë, paanshmëri dhe kultivon një kulturë të fortë të cilësisë dhe integritetit akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>UET ka zhvilluar politika dhe strategji të qarta për sigurimin e brendshëm të cilësisë, të cilat janë të formalizuara në kuadrin rregullator dhe të shoqëruara me struktura funksionale që mbështesin zbatimin e tyre. Organizimi i veprimtarive në këtë fushë karakterizohet nga transparenca dhe përfshirja e aktorëve të ndryshëm institucionalë, duke garantuar qasje të hapur për studentët dhe palët e interesuara. Informacioni mbi proceset dhe aktivitetet e sigurimit të brendshëm të cilësisë publikohet në faqen zyrtare të universitetit dhe shpërndahet përmes kanaleve zyrtare të komunikimit, duke siguruar llogaridhënie dhe përputhje me standardet kombëtare e ndërkombëtare të arsimit të lartë.</p> <p><i>http://eut.edu.al/rreth-uet/</i> E. 56. Kodi i Etikës</p>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	<p>UET ka zbatuar me korrektësi kriterin e transparencës për publikimin e rezultateve të vlerësimeve të programeve të studimit. Rezultatet publikohen në faqen zyrtare të universitetit, duke u bërë të aksesueshme për studentët, stafin akademik dhe palët e interesuara. Procesi i publikimit respekton parimet e lirisë dhe etikës akademike, si dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Gjithashtu, UET-ja ka treguar kujdes për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm, duke siguruar që transparenca të kombinohet me mbrojtjen e të drejtave të</p>

	<p>individëve. Kjo praktikë përbën një tregues pozitiv ndaj standardeve të cilësisë dhe llogaridhënies.</p> <p><i>E. 56. Kodi i Etikës</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit të KSBC shoqërohen me plan masash, i cili synon adresimin e mangësive dhe reduktimin ose eliminimin e dobësive të evidentuara, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë që nga njësia bazë. Mbledhjet e departamentit me personelin akademik zhvillohen periodikisht, çdo javë, ku analizohen dhe diskutohen në detaje ecuria dhe problematikat e procesit mësimor dhe kërkimor, si dhe sugjerohen masa për ndërhyrje në përputhje me gjetjet dhe nevojat. Më pas, në nivel njësie bazë dhe kryesore, bazuar në propozimet e bëra, hartohet plani i masave në nivel universiteti. Ky plan miratohet nga Senati Akademik dhe zbatohet në vitin pasues.</p> <p><i>E. 30.3 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2023-2028, Veprimtaria, Monitorimi, Vlerësimi dhe Përmirësimi.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë e vlerëson institucioni, duke siguruar përmirësimin në vijim të programit të studimit Master i Shkencave në: “Shkenca Komunikimi” me profile “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu”. Përditësimet vjetore të programeve të lëndëve (syllabuset), si dhe pasurimin e kurrikulave përmes përfitimeve nga pjesëmarrja e personelit në projekte ndërkombëtare dhe aktivitetet individuale kërkimore-shkencore të stafit akademik sipas fushave të ekspertizës, përbëjnë pjesë të këtij përmirësimi. Për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit angazhohet personeli akademik në mënyrë aktive dhe me përkushtim.</p> <p><i>E. 43.2 Të dhëna për kërkimin shkencor të programit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të</p>	<p>Për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në: “Shkenca Komunikimi” me profile “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu”, institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët.</p> <p>Me qëllim informimin, ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive të tyre në sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së</p>

<p>cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>programit të studimit, veprimtaritë periodike përfshijnë mbledhjet e Asamblesë së pedagogëve, trajnimet e ndryshme, publikimet në faqen zyrtare të UET dhe platformën UET LMS, si dhe publikime në rrjetet sociale.</p> <p>Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për të garantuar transparencën dhe ndërgjegjësimin e tyre në proceset e sigurimit dhe përmirësimit afatgjatë të cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në: “Shkenca Komunikimi” me profile “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu”.</p> <p>Veprimtaritë periodike, duke përfshirë mbledhjet e Asamblesë së pedagogëve, trajnimet e ndryshme, publikimet në faqen zyrtare të UET dhe platformën UET LMS, si dhe publikimet në rrjetet sociale, synojnë të forcojnë përfshirjen aktive, ndërgjegjësimin dhe informimin e studentëve dhe stafit akademik në sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>E. 33 Të dhëna për trajnime profesionale për stafin</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni siguron transparencë të plotë dhe akses publik në politikat dhe aktivitetet e sigurimit të brendshëm të cilësisë, duke respektuar legjislacionin dhe etikën akademike, përmirëson vazhdimisht cilësinë e programit përmes planeve konkrete të masave, diskutimeve të rregullta dhe veprimtarive periodike me personelin dhe studentët. Për informim dhe përfshirje aktive, institucionit përdor gjithashtu platforma digjitale dhe rrjete sociale, duke e bërë procesin të hapur dhe të qasshëm për të gjithë aktorët e përfshirë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X
<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile “Marrëdhënie Publike Politike”, “Menaxhim Marketingu” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti European i Tiranës

Pika të forta:

- Programi ka një strukturë të qartë akademike me rezultate të nxënies të përcaktuara mirë dhe të përputhura me kompetencat profesionale dhe shkencore.
- Mësimdhënia dhe mësimnxënia bazohen në zhvillimin e kompetencave, duke përfshirë aktivitete praktike dhe integrimin e njohurive të avancuara shkencore.
- Proceset e vlerësimit të studentëve janë transparente, të vazhdueshme dhe mbështeten në rregullore dhe mekanizma efektivë të sigurisë së cilësisë.
- Bashkëpunimet me institucione dhe organizata të ndryshme ofrojnë mundësi të shumta për praktikë dhe zhvillim profesional për studentët.
- Programi nxit mobilitetin dhe ndërkombëtarizimin përmes ofrimit të lëndëve në gjuhën angleze dhe pjesëmarrjes në programet Erasmus .
- Programi organizohet dhe administrohet në përputhje me politikat institucionale dhe siguron mbështetje të duhur administrative.
- Metodatat e vlerësimit janë të larmishme, transparente dhe u japin mundësi studentëve të demonstrojnë kompetencat e fituara.

Pika të dobta

Gjatë vlerësimit nuk janë evidentuar dobësi specifike.

Rekomandime:

- Përqendrimi i funksioneve vendimmarrëse në një individ të vetëm (Dekani i fakultetit, njëkohësisht shef departamenti i programit të studimit), pa dokumentim të mjaftueshëm të mekanizmave të pavarur për adresimin e ankesave dhe mbrojtjen e lirisë akademike.
- UET duhet të ndërmarrë masa shtesë teknike dhe organizative, të cilat parashikojnë njoftimin paraprak dhe marrjen e dakordësisë së personit të përfshirë për verifikimin e të dhënave personale, duke kufizuar aksesin vetëm për personat e autorizuar. Duhet të marrin një deklaratë stafit që i autorizon burimet njerëzore për verifikimin e dokumentacionit të tyre dhe përpunimin e të dhënave personale.
- Duke marrë parasysh situatën aktuale të stafit akademik në Departamentin e Shkencave Humane dhe Komunikimit, rekomandohet një fokus më i madh në avancimin profesional dhe shkencor të stafit, duke inkurajuar fitimin e gradave të larta akademike. Për më tepër, duke qenë se Shkencat e Komunikimit përbëjnë një fushë ndërdisiplinore, por me kërkesa specifike, është e nevojshme që departamenti të angazhojë më shumë personel akademik me specializime të drejtpërdrejta në këtë fushë, për të siguruar një mbështetje cilësore dhe të qëndrueshme të programit të studimit.
- Duke mbajtur në konsideratë veçorinë e strukturës organizative të fakultetit, ku Dekani i Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale mban

104



njëkohësisht edhe funksionin e Shefit të Departamentit të Shkencave Humane dhe Komunikimit, rekomandohet që institucioni të sigurojë dhe të dokumentojë qartë ekzistencën dhe funksionimin e mekanizmeve të pavarur për trajtimin e ankesave dhe garantimin e lirisë akademike. Kjo do të forcojë transparencën institucionale dhe do të mbështesë një klimë akademike të drejtë, të hapur dhe të bazuar në parimin e ndarjes së funksioneve, duke ruajtur njëkohësisht efikasitetin e strukturës aktuale organizative.

- Të zhvillohen më tej mekanizmat për marrjen e feedback-ut të vazhdueshëm nga alumni-t për të siguruar përshtatjen e programit me nevojat e tregut dhe zhvillimet shkencore.
- Gjatë procesit të verifikimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të stafit akademik dhe ndihmës akademik, rekomandohet që institucioni të sigurojë respektimin e standardeve të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin përkatës. Duhet të garantohen masa teknike dhe organizative që informojnë paraprakisht dhe marrin dakordësinë e personit të përfshirë për verifikimin e të dhënave të tij personale, duke kufizuar aksesin vetëm për personat e autorizuar.

Conclusions of the Evaluation of the Second Cycle Master of Science Program in “Communication Sciences” with profiles in “Political Public Relations” and “Marketing Management,” offered by the Higher Education Institution “European University of Tirana”

Strengths:

- The program has a clear academic structure with well-defined learning outcomes aligned with professional and scientific competencies.
- Teaching and learning are based on competency development, incorporating practical activities and integrating advanced scientific knowledge.
- Student assessment processes are transparent, continuous, and supported by regulations and effective quality assurance mechanisms.
- Collaborations with various institutions and organizations provide students with multiple opportunities for professional development and practical training.
- The program promotes mobility and internationalization through the offering of courses in English and participation in Erasmus programs.
- The program is organized and managed by institutional policies, ensuring adequate administrative support.
- Assessment methods are diverse, transparent, and allow students to demonstrate their acquired competencies.

Weaknesses:

No specific weaknesses were identified during the assessment.

Recommendations:

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjimnazit “Qemal Stafa”, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al



- The concentration of decision-making functions in a single individual (the Dean of the Faculty also serving as Head of Department of the study program), without sufficient documentation of independent mechanisms for addressing complaints and safeguarding academic freedom.
- UET should undertake additional technical and organizational measures, which ensure prior notification and obtain the consent of the person concerned for the verification of personal data, while restricting access only to authorized individuals.
- Considering the current composition of the academic staff in the Department of Humanities and Communication, it is recommended to emphasize the professional and academic advancement of staff members, encouraging the pursuit of higher academic degrees. Furthermore, given that Communication Sciences is an interdisciplinary field with specific academic requirements, the department is encouraged to engage more academic personnel with direct specialization in this field to ensure qualitative and sustainable support for the study program.
- Considering the organizational structure of the faculty, where the Dean of the Faculty of Humanities, Education, and Liberal Arts simultaneously holds the position of Head of the Department of Humanities and Communication, it is recommended that the institution ensure and document the existence and functioning of independent mechanisms for handling complaints and guaranteeing academic freedom. This would strengthen institutional transparency and support a fair and open academic climate, while maintaining organizational efficiency.
- Mechanisms for obtaining continuous feedback from alumni should be further developed to ensure that the program remains aligned with labor market needs and scientific developments.
- During the verification and review process of academic and administrative staff documentation, it is recommended that the institution ensure compliance with confidentiality and personal data protection standards, following relevant legislation. Technical and organizational measures must be in place to inform individuals in advance and obtain their consent before data verification, limiting access only to authorized personnel.

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

